



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 798/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.12.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-33068-08-07-2019, me objekt: *LOTI 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë”*, me fond limit 9,943,883 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.09.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Fatos Lashi” p.f, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “NRG” sh.p.k. në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Tre vëllezërit Kondi”, nr. 6/1, Tiranë.

Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" sh.p.k.
Adresa: Rr. "Fatmir Haxhiu", P.2, Shk.10, Ap.76, Tiranë.

Operatori ekonomik "Fatos Lashi" p.f.
Adresa: Rruga e Kavajës, godina "Condor Centre", K.4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Instituti i Shëndetit Publik
Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.80, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesit dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ankimuesit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Ankimuesit kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të ankimuesve.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.08.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-33068-08-07-2019, me objekt: *LOTI 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë”*, me fond limit 9,943,883 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.09.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.

II.2. Në datën 09.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 23.09.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k.	34,402.50 lekë, Skualifikuar
2. “Air” sh.p.k.	35,005.00 lekë, Skualifikuar
3. “Pastrime Silvio” sh.p.k.	41,004.00 lekë, Skualifikuar
4. “Alpen Pulito” sh.p.k.	40,035.00 lekë, Skualifikuar
5. “NRG” sh.p.k.	51,010.00 lekë, Kualifikuar
6. “Fatos Lashi” p.f.	73,705.00 lekë, Skualifikuar

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“1. Fatura e datës 19/05/2017 me nr.V2/77/2017 nga Tifone ambient, dhe fatura IEnv Solution l.t.d dt. 06.03.2019, nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe. Sipas DST-ve, kapitulli I; NJOFTIMI I KONTRATËS pika4.6, gjuha 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: , është gjuha shqipe. Jeni në kundërshtim me VKM –në nr. 914 datë 29/12/2014 për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik (të ndryshuara), neni 14 pika 2.

2. Të dhënat e sigurise të produkteve Vectobac WDG dhe Vectobac G, është njësuar vetëm përkthimi, por nuk është bërë njësia me origjinalin. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi.

3. Formulari i ofertës Shtojca 1 (Lot1) duhet të kishit deklaruar në pikën (1) dhe në pikën(2) , më gërma dhe me numra vetëm shumatoren e cmimeve për njësi. Plotësimi i formularit nga ana juaj është bërë në kundërshtim me DST e tenderit, dhe Rekomandimit nr. 10419, datë 26.11.2018 të APP “Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër””

II.4.1.Në datën 27.09.2019, operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së

për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Autoriteti kontraktor referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë qëllimit thelbësor për të cilën është hapur procedura e prokurimit publik, ku duke mos përjashtuar njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë. të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës duke mos penalizuar pa të drejte operatorët ekonomike, dhe duke pranuar pa të drejte operatore ekonomike në kundërshtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të procedurës së tenderimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit Autoriteti kontraktor ka refuzuar ofertën 9180/08.09.2019 për tenderin REF33068-08-07-2019” Loti 1 Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë”, me fond limit të planifikuar në vlerën 9,943,883 (nëntë milionë e nëntëqind e dyzetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSh të operatorin ekonomik “ Akademia e Shëndetit Publik” me arsyetimin: 1.Fatura e datës 19.05.2017 me nr. V2/ 77/2017 nga Tifone ambient dhe Fatura IEnv Solutoin Ltd me date 06.03.2019, nuk janë të përkthyer ne gjuhen shqipe,

1. Sqarojme se : 1.1. Te gjitha fatura te depozituara janë bere sipas parashikimeve te DST, ku vlen te përmendet se janë te gjitha origjinale dhe ne gjuhen shqipe se bashke dhe me dokumentacionin shoqërues se mallit sic janë deklaratat doganore te depozituara pranë autoriteti kontraktor, Vlen te theksohet se deklarata doganore te lëvrimit te malli janë ne gjuhen shqipe sipas parashikimeve te DST Kap 1, pika4.6, gjuha. Pra duke qene se e gjitha procedura e tenderit i gjithë dokumentacioni qe kemi paraqitur është ne gjuhen shqipe dhe origjinal. Edhe dokumentacioni shoqërues i malli për faturat e datës 19.05.2017 dhe datës 06.03.2019 ku ne ketë futet edhe praktika dogane është ne gjuhen shqipe dhe origjinal. Prandaj nuk përben shkak për s’kualifikim si operator ekonomike. Te gjitha gjetjet nga KVO janë ne kundërshtim me te dhënat specifike duke abuzuar me kompetencat e vete ligjit.

2. Te dhënat e sigurisë te produkteve Vectobac WDG dhe Vectobac G, është njësuar vetëm përkthimi, (sipas KVO dokumentacioni nuk është i sakte)

Sqarojme se : 2.1. Te dhënat e sigurisë te produkteve Vectobac WDB dhe Vectobac G janë paraqitur origjinale dhe te përkthyer se bashku me vërtetim përkthimin qe do te thotë nuk është i nevojshme njësimi me origjinalin për aq kohe sa dokumentacioni është origjinal dhe i përkthyer ne gjuhen shqipe se bashku me vërtetim përkthimin sipas legjislacionit mbi noterinë. Prandaj nuk përben shkak për s’kualifikim si operator ekonomike. Te gjitha gjetjet nga ana juaj janë ne kundërshtim me te dhënat specifike duke abuzuar me kompetencat e vete ligjit.

3. Formulari i ofertës Shtojca 1 (Lot 1) duhet te kishin deklaruar ne piken (1) dhe ne piken (2), me germa dhe me numra vetëm shumatoren e çmimeve për njësi.

Sqarojme se : Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Në nenin 53,

pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. 3.1. Ne Udhëzimin nr. 15 pika 7 date 26.11.2018 “ Për një ndryshim ne Udhëzimin nr. 6 date 16.01.2018 “ Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” Fondi limit mbi të cilin autoriteti kontraktor do të shpalle procedurën e prokurimit është vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Ne rastin kur, objekti i prokurimit përbehet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomike do të behet mbi shumatorën e çmimeve për njësi e cila publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) ne njoftimin e kontratës. Analiza ligjore që bën autoriteti kontraktor është si rrjedhojë e interpretimi të gabuar në lidhje me çmimi për njësi apo fondin limit si dhe me subjektet e shumta që paraqesin ofertën duke u bazuar në çmimin në njësi. Operatori ekonomik “Akademia Shëndetit Publik” përveç ofertës që përben çmimin total, ka paraqitur edhe tabelën dhe zërin e punimeve duke u bazuar në çmimet për njësi ku shumatoria e këtyre çmimeve jep çmimin final të ofertës të dhëne nga operatori ekonomik. Formulari ofertes e thote qarte se ku duhet të plotesohet vlera totale dhe ku duhet të plotesohet vlera totale e çmimit për njësi. Edhe në pikën 1 dhe 2 nese do kerkonte shumatore do të shprehej jo si vlere totale po si vlere totale e çmimit për njësi ose si shumatore. DST kerkon vleren totale të ofertes në pikën 1 dhe 2 dhe çmimin dhe shumatore oferta e kerkon të plotesohet në tabelën e meposhtme që kerketat janë shume të qarta dhe plotesimi eshte bere korrekte. Kete e tregon edhe fakti i paraqitur në renditjen tuaj ku e keni pranuar oferten tone dhe na keni renditur te parët. Prandaj nuk përben shkak për s’kualifikim si operator ekonomike. Te gjitha gjetjet nga ana juaj janë në kundërshtim me të dhënat specifike duke abuzuar me kompetencat e vete ligjit.

Shqytimi administrativ i veprimtarisë qeveritare e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një administratë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në baze të ligjit dhe e afte për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejte. Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli administrativ shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së qeverisjes së mire. Që një rend qeverisje në një shoqëri të caktuar të realizojë me sukses zhvillimin e shoqërisë, duhet të ketë një aparat shtetëror sa me të organizuar dhe efektiv. Në një shtet demokratik realizimi i funksioneve shtetërore kërkon se pari një organizim sa me të mire të aparatit shtetëror dhe në veçanti të atij administrativ, një administratë me nëpunës të afte profesionalisht pasi profesionalizmi dhe qëndrueshmëria e tyre në punë paraqet domosdoshmërisht një qëndrueshmëri të administratës publike. Çmojmë të nevojshme, se çdo organ administrativ është kompetent në fushën që ai mbulon dhe nuk mundet të ushtrojë të drejtat e një organi tjetër, pasi ushtrimi i kompetencave të ligjit, përbën cenim të parimit të ligjshmërisë dhe si rrjedhojë, çdo veprim apo akt administrativ që mund të nxirret nga kjo veprimtari e pakufizuar dhe arbitrare, mund të shpie domosdoshmërisht në pavlefshmëri juridike të këtyre akteve administrative”

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1176/30 Prot. datë 03.10.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik

ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

”[...] 1. Përsa i përket pretendimit në lidhje me dokumentat të cilat janë në gjuhën shqipe (faturat e blerjes... për kualifikimin e OE AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK) sqarojmë si më poshtë: Në nenin 14 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”, ndërsa në dokumentet e tenderit, Njoftimi i kontratës, pika 4.6 është përcaktuar shprehimisht: 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër. Nga shqyrtimi, në dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi “AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK” sh.p.k. në sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se OE ka paraqitur faturat e shitjes së mallit në gjuhën e huaj, të pa përkthyer në gjuhën shqipe. KSHA konstaton se, në përmbushje të kriterëve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit objekt shqyrtimi, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dy fatura blerje në gjuhë të huaja dhe të pashoqëruara me përkthim të noterizuar (konkretisht fatura me nr. V2/77/2017, datë 19.05.2017 dhe fatura me nr. 0000089630, datë 06.03.2019), duke e bërë të pamundur identifikimin e qartë të pajisjes së blerë me përshkrimin në faturën doganore, specifikisht për paisjen “Atomizator shpine me motorr për granula“, për Lotin 1, ku për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: "faturën e blerjes së pajisjes atomizatorit ose në rastin kur pajisja (atomizator) është në përdorim, OE duhet të paraqesë kontratën e qirasë të shoqëruar me faturën e blerjes së pajisjes atomizator". Për sa më sipër, OE “AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK” sh.p.k. nuk e ka sjelle faturën IEnv Solution ltd më datë 06.03.2019, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të Autoritetit Kontraktor në dokumentet e tenderit në kriteret e veçanta për kualifikim. Përcaktimi i bërë në dokumentet e tenderit, kapitulli I; NJOFTIMI I KONTRATËS pika 4.6, gjuha 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: është gjuha shqipe. Për më tepër që në VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 14 pika 2, është përkufizuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Për sa më sipër, pretendimi i OE “AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK” sh.p.k. nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

2. Për sa i përket pretendimit të dytë për Dokumentin të Dhënat e Sigurisë të Produktit Vectobav WG dhe Vectobac G, sqarojmë se në Dokumentet Standarde të Tenderit, shtojca nr. 8 është përshkruar qartë "Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim". Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se dokumentat e paraqitura nga Ju nuk janë origjinalë ose njësi me origjinalin. Për sa më sipër, pretendimi i OE “AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK” sh.p.k. nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

3. Përsa i përket pretendimit të tretë se Formulari i Ofertës i dorëzuar nga ana juaj, është i rregullt, ju sqarojmë se: Në Formularin e ofertës Shtojca 1 (Lot 1) duhet të kishit deklaruar në pikën (1) dhe në pikën (2), më gërma dhe me numra vetëm shumatoren e çmimeve për njësi. Plotësimi i formularit nga ana juaj është bërë në kundërshtim me DST dhe Rekomandimit nr. 10419, datë 26.11.2018 të APP “Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër” si dhe me pikën 7.3 të udhëzimit nr. 6 datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me

mjete elektronike ” i ndryshuar ku në paragrafin e fundit përcaktohet se: Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga Operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përlllogaritur për çdo artikull apo shërbim, nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër, pretendimi i OE “AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK” sh.p.k. nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet. [...]”

II.4.3.Në datën 11.10.2019, operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k., për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“1. Dokumenti “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid”, lëshuar nga ANSES datë 19/08/2019 për Aquabac DF 3000 me nr FR 2019-0101, dhe Aquabac 200 G me nr. FR 2019-0099, nuk është origjinale ose njësi me origjinalin. Ky dokument është shoqëruar vetëm vërtetimi i përkthimit, dhe nuk është paraqitur origjinali ose njësia me origjinalin. Çertifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së mjedist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dt. 12 Mars 2016, për produktin me përmbajtje të Bti BMP 144 DF 3000 me nr. rregjistrimi 62637-14 dhe Bti BMP 144 (200 G) me nr. rregjistrimi 62637-3, është paraqitur vetëm përkthimi dhe dokumentat nuk janë original dhe njësinë me origjinalin. (Edhe dokumenti i letrës se Anses së dt 08 Shtator 2016, është dokument kopje, e cila vërtetohet edhe nga përkthimi). Dokumentat e mësipërme nuk janë të rregullta. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi

2. Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për AQUABAC 3000DF, është paraqitur vetëm me vërtetim të përkthimit dhe jo origjinal ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2019-03-10; data e prodhimit mars: 2019 dhe data e skadimit Mars 2021. (si dhe janë shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (te dhëna keto te cilat nuk janë në dokumentin në gjuhën angleze) Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për AQUABAC 200G, është paraqitur vetëm me vërtetim përkthimi dhe jo origjinali ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2018-12-01; data e prodhimit Dhjetor: 2018 dhe data e skadimit: Dhjetor 2021. (si dhe janë shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (te dhëna këto të cilat nuk janë në dokumentin në gjuhën angleze). Pra në dokumentin e përkthyer janë shtuar shënime të cilat nuk janë në dokumentat në gjuhën angleze. Dokumentat e paraqitura më sipër nuk janë njësi me origjinalin ose origjinale Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi.

3. Skedat teknike të Aquabac 200 g dhe Aquabac DF 3000 të vitit 2018 nuk janë dokumenta njësi me origjinalin, ose origjinale. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është I saktë, gjë e cila përbën kusht

s'kualifikimi. Fishat teknike te paraqitura nga CERA, të vitit 2019 (edhe pse Fishat teknike të viti 2019 nuk janë hartuar nga kompania prodhuese), nuk janë dokumenta njësi me origjinalin, ose origjinale Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është I saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.

4. Nuk është paraqitur asnjë informacion apo dokumentacion në lidhje me rregjistrimin në ECHA të produkteve Biocideve Aquabac 200 G dhe Aquabac DF 3000.. U verifikua edhe në sistemin e ECHA dhe produktet e ofruara sipas ëeb site janë ne statusin e anuluar, për Francën

5. Skeda teknike e Dozatorit MMF është e gabuar. Dozatori I parqitur nga ju nuk plotëson specififikimet teknike të cilat kërkohen nga DST e tenderit “shtojca 9 “, ku kërkohet se “..... OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m². . Skeda teknike e paraqitur nga ana e Pastrimi Silvio shpk është dozator mekanik i rregullueshëm (DOSAMATIC gr), e cila tregon qartësisht tek fusha e aplikimit të pasijes e cila përdoret për produkte me formulime granule me doze (nga 2gr -10 gr), ndërkohë që DST e kërkojnë për përdorim me formulim lëng deri ne 1ml. Nuk plotëson kriteret e vecanta per kualifikim ne lidhje paisjen Dozatore MMF dhe specififikimet teknike per Dozatorin per MMF. 6. Formulari i ofertës Shtojca 1 (Lot1) duhet të kishit deklaruar në pikën (1) dhe në pikën(2) , më gërma dhe me numra vetëm shumatoren e cmimeve për njësi. Plotësimi i formularit nga ana juaj është bërë në kundërshtim me DST e tenderit , dhe Rekomandimit nr. 10419, datë 26.11.2018 të APP “Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër”. Për sa më sipër OE Pastrimi Silvio shpk, nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim (pika2 Shtojca8); përkatësisht pika 3.3 “kapaciteti teknik”, pika 2 (per skeden teknike te dozatorit MMF), pika 3 (shkronja a. dhe b.), pika 4 dhe formulari i ofertës nuk eshte i paarqitur sakte sispasDST-ve, Dokumenta si te spjeguar me larte nuk janë origjinale ose njësi me origjinalin, sipas paragrafit të fundit të shtojcës 8 Ne lidhje me dokumentat e paraqitura për produktet biocide (aquabac200G dhe aquabac DF 3000), te paraqitura nga OE Pastrimi Silvio u verifikuan ëeb sitet si me poshte me daten 23/09/2019: • site ECHA në lidhje me rregjistrimin e produkteve biocide në lidhje me produktet, Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000 <https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0008703-0000/authorisationid> dhe <https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0009287-0000/authorisationid>, rezultuan me statusin anuluar (cancelled) për Francën,nga i cili eshte paraqitur dokumentacioni. • site e distributori CERA, lidhje me produktet, Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000 <http://cera-biocide.fr/aquabac-df3000/> dhe <http://cera-biocide.fr/aquabac-200g/>, vazhdojne te jenë të paraqitur vetëm rregjistrimet FR -2016-0054 për AQUABAC DF 300 dhe FR -2016-0053 Aquabac200G, si dhe skedat teknike jane end te vitit 2016. • site ANSES ne lidhje me rregjistrimin e biocideve. Nga verifikimet rezultuan se produktet Aquabac DF 3000 ka rregjistrimin FR2016-0054 dhe Vendimi i publikuar ne ëeb site eshte ende i anuluar. Gjitashtu edhe produkti Aquabac 200G, i cili ka rregjistrimin FR 2016-0053, Vendimi i publikuara eshte i anuluar. Vendimet e Anses te publikuara jane te anulluara qe prej dates 29 June 2018. https://www.anses.fr/en/system/files/biocides/decisions/AQUABACDF3_PB-13-00424_BAMM_D.pdf dhe https://www.anses.fr/en/system/files/biocides/decisions/AQUABAC200G_PB-13-00422_BAMM_D.pdf”

II.5.1.Në datën 27.09.2019, operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon: “[...]Nuk jemi dakord me asnjë nga arsyet e skualifikimit tonë, arsye të pabazuara në ligj e në fakt, si më poshtë:

1. Nuk jemi dakord me arsyen e parë të skualifikimit sipas së cilës “1. Dokumenti “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid lëshuar nga ANSES datë 19/08/2019 për Aquabac DF 3000 me nr FR 2019-0101, dhe Aquabac 200 G me nr. F R 2019-0099, nuk është origjinale ose njësi me origjinalin. Ky dokument është shoqëruar vetëm vërtetimi i përkthimit, dhe nuk është paraqitur origjinali ose njësia me origjinalin. Çertifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dt. 12 Mars 2016, për produktin me përmbajtje të Bli BMP 144 DF 3000 me nr. rregjistrimi 6263 7-14 dhe Bti BMP 144 (200 G) me nr. rregjistrimi 6263 7-3, është paraqitur vetëm përkthimi dhe dokumentat nuk janë original dhe njësinë me origjinalin. (Edhe dokumenti i letrës se ANSES së dt. 08 Shtator 2016, është dokument kopje, e cila vërtetohet edhe nga përkthimi). Dokumentat e mësipërme nuk janë të rregullta. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi.”

Për plotësimin e pikës 5 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, sipas së cilës “OE duhet të paraqesë certifikatën e regjistrimit të produkteve biocide me agjent biologjik Bti EG dhe Bti G, në një prej vendeve të Bashkimit Europian ose në Angli, Zvicër, Kanada, Australi, dhe SHBA të regjistruar në ECHA (Agjencia Evropiane e Kimikateve, organi më i madh për kimikatet në Evropë)”, kemi dorëzuar dy vendime (Vendim në lidhje me kërkesën e autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid nr. AMM: FR-2019-0101 dhe nr. AMM: FR-2019-0099) të Ministrisë Franceze. Vendimi i parë “Vendim në lidhje me kërkesën e autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr.AMM: FR-2019-0101” për produktin Aquabac DF 3000, prej 6 faqesh, firmosur dhe vulosur nga Drejtoresha e Përgjithshme e Deleguar (Dr. Caroline SEMAILLE) dhe, Vendimi i dytë “Vendim në lidhje me kërkesën e autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr.AMM: FR-2019-0099” për produktin Aquabac 200 G, prej 5 faqesh, të firmosur dhe vulosur nga Drejtoresha e Përgjithshme e Deleguar (Dr. Caroline SEMAILLE). Në kundërshtim me sa shprehet, për arsyen e skualifikimit si më sipër, kemi dorëzuar për plotësimin e pikës 5, të Kapacitetit teknik të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, Vendimin original për secilin produkt, me firmë dhe vulë të Ministrisë Franceze. Vendim i shoqëruar me përkthimin përkatës dhe Vërtetimin e përkthimit nga noteri. Nuk është e vërtetë që nuk është paraqitur dokumenti origjinal apo i përkthyer me origjinalin, pasi është dorëzuar Dokumenti original, shoqëruar më përkthimin nga gjuha franceze si dhe, vërtetimi i përkthimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo arsye skualifikimi është absolutisht e pavleshme, pasi dokumentacioni i pretenduar se nuk është dorëzuar apo nuk është dorëzuar sipas formës së kërkuar, nuk është i vërtetë pasi, çdo gjë është dorëzuar sipas formës së kërkuar nga legjislacioni në fuqi dhe DST. Ndërkohë, Çertifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 12 Mars 2016, është dorëzuar si dokumentacion shtesë për të vërtetuar plotësimin e pikës 4 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit. Pra, nëpërmjet tij vërtetohet që produkti me të cilin ne kemi ofertuar është i regjistruar si në SHBA ashtu edhe në Europë, duke plotësuar kërkesën e pikës 5 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor

për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike dhe stafin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm, për realizimin e kontratës me sukses, në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarde të tenderit. Me dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë, vërtetohet qartësisht që produkti i nevojshëm për kryerjen e shërbimit objekti i këtij prokurimi është i rregjistruar në disa shtete (sipas kërkesës së vendosur nga AK në DST). Autoriteti nuk ka vlerësuar thelbin e dokumentacionit të paraqitur, i cili në kundërshtim me sa thuhet është paraqitur sipas formës së kërkuar, por vlerëson aspekte aspak të rëndësishme që nuk i shërbejnë vlerësimit të Autoritetit Kontraktor dhe sigurisë që ai kërkon që shërbimi do të kryhet në kohë dhe sipas kërkesave e specifikimeve të vendosura nga vetë ai. Për më tepër, dokumentacioni nga Ministria e Mjedisit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është dorëzuar si shtesë informacioni, pasi kërkesa që produkti të jetë i rregjistruar është plotësuar nga ana jonë me dorëzimin e dy Vendimeve të Ministrisë Franceze. Autoriteti na skualifikon për faktin se kemi treguar që produkti me të cilin kemi ofertuar, nuk është i rregjistruar vetëm në Europë, por edhe në shtete të tjera. Për sa më sipër, kjo arsye skualifikimi është e pabazuar dhe si e tillë e pavlefshme. Ajo nuk qëndron për gjitha sa shprehem më sipër.

2. Nuk jemi dakord me arsyen e dytë të skualifikimit sipas së cilës “2. Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për AQUABAC 3000DF, është paraqitur vetëm me vërtetim të përkthimit dhe jo original ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2019-03-10; data e prodhimit mars: 2019 dhe data e skadimit Mars 2021. (si dhe janë shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (te dhena keto te cilat nuk janë në dokumentin në gjuhën angleze). Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për AQUABAC 200G, është paraqitur vetëm me vërtetim përkthimi dhe jo origjinali ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2018-12-01; data e prodhimit Dhjetor 2018 dhe data e skadimit: Dhjetor 2021. (si dhe janë shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (te dhena këto të cilat nuk janë në dokumentin në gjuhën angleze). Pra në dokumentin e përkthyer janë shtuar shënime të cilat nuk janë në dokumentat në gjuhën angleze. Dokumentat e paraqitura më sipër nuk janë njësi me origjinalin ose origjinale. Në DST, shtojca nr. 8, Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi.” Për plotësimin e pikës 4 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të veçanta të kualifikimit sipas së cilës “OE duhet të paraqesë etiketat/katalog dhe Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë për të gjitha produktet e përcaktuara sipas loteve në lidhje me lëndët dezinfektuese që do të përdoret në trajtim sipas formulimeve të përcaktuara në specifikimet teknike më poshtë...”, kemi dorëzuar: Skedë Sigurie, Skedë teknike, etiketa, vërtetim nga CERA. Të gjithë dokumentet janë të përkthyer dhe të shoqëruara me vërtetim përkthimi. Në kundërshtim me sa shprehet KVA, të gjithë dokumentet janë ose origjinale, ose të njësuara me origjinalin. E ftojmë KVA të rishikojë dokumentet e dorëzuara nga ana jonë, ku do të konstatojë se ato janë të skuanuara origjinale, ose të njësuara me origjinalin. Etiketa është

përshatur me nevojat e tregut tonë dhe është përgatitur për tu përdorur në tregun shqiptar, ku me autorizim dhe udhëzim të kompanisë doistributorë është bërë dhe shtesa në fund të etiketave. Kjo arsye skualifikimi, e lidhur me arsyen e mëposhtme të skualifikimit, të cilën e kemi sqaruar më poshtë, është e pavlefshme dhe si e tillë nuk qëndron.

3. Nuk jemi dakord me arsyen e tretë të skualifikimit sipas së cilës “3. Skedat teknike të Aquabac 200 g dhe Aquabac DF 3000 të vitit 2018 nuk janë dokumenta njësi me origjinalin, ose origjinale. Në DST, shtojca nr. 8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi. Fishat teknike të paraqitura nga CERA, të vitit 2019 (edhe pse Fishat teknike të vitit 2019 nuk janë hartuar nga kompania prodhuese), nuk janë janë dokumenta njësi me origjinalin ose origjinale. Në DST, shtojca nr. 8, Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi.” Siç kemi shprehur më sipër, bëhet fjalë për të njëjtën arsye skualifikimi (duke qenë se kërkesa për etiketa/katalogje dhe skeda teknike ishte 1 kërkesë e vetme dhe Autoriteti vetëm sa ka shtuar në mënyrë artificiale arsyet e skualifikimit). Skedat teknike të produkteve janë të publikuara online në format pdf. Të gjitha kompanitë i publikojnë skedat teknike dhe të sigurisë së produkteve të tyre, në ëeb-site-t e tyre, nga ku mund të shkarkohen nga personat e interesuar. Pra, në thelb, skeda teknike është një informacion në lidhje me produktin, në format pdf, që publikohet nga kompania prodhuese. Në disa raste, kompanitë prodhuese i firmosin dhe vulosin Skedat Teknike dhe të Sigurisë, në disa raste nuk i firmosin (siç është në rastin konkret). Noterizimi i një dokumenti të tillë, nuk ka asnjë vlerë ligjore. Përse duhet të noterizohet një dokument që nuk ka as vulë dhe as firmë, pra, nuk përmbush kushtet ligjore për tu njësuar me origjinalin? Në qoftë se, Autoriteti Kontraktor ka dyshime në lidhje me vërtetësinë e dokumentit, mund të bëjë verifikimet përkatëse, sipas të dhënave që ndodhen tek vetë skedat teknike. Skedat teknike të dy produkteve që ne kemi paraqitur (Aquabac 200 G dhe Aquabac DF 3000) janë të hartuara nga kompania prodhuese (Becker Microbial Products inc). Gjithashtu, kompanitë prodhuese mund të bëjnë ndryshime/rishikime në skedat teknike të publikuara prej tyre, ndërkohë në rastin konkret është bërë edhe një sqarim teknik i dy produkteve, nga kompania distributore, me kërkesë të personave të interesuar, gjë që nuk e bën të pavlefshëm atë. Dokumenti është i saktë dhe na është sjellë nga kompania distributore e tyre për Europën, CERA. Ku qëndron problemi, në ndryshimet, rishikimet apo shtimet që ka bërë kompania distributore e produkteve? Materiali është përshatur me kërkesat e tregut në të cilat ajo po vepron. Ky dokument nuk është ndryshuar në formë apo përmbajtje nga ana jonë dhe përkthimi është njësoj si dokumenti që na është sjellë nga kompania distributore CERA SAS. Nuk mund të noterizohen dokumentet, në momentin që nuk janë të firmosura dhe vulosura, pra, nuk janë sipas formës ligjore të kërkuar për tu njësuar me origjinalin (subjektin që i ka nxjerrë, firma e titullarit, vula e subjektit). Për sa më sipër, kjo arsye skualifikimi si dhe arsyeja e mëparshme e skualifikimit janë të pavlefshme dhe si të tilla nuk qëndrojnë.

4. Nuk jemi dakord me arsyen e katërt të skualifikimit sipas së cilës “4. Nuk është paraqitur asnjë informacion apo dokumentacion në lidhje me rregjistrimin në ECHA të produkteve Biocide Aquabac 200 G dhe Aquabac DF 3000.. U verifikua edhe në sistemin e ECHA dhe produktet e ofruara sipas ëeb site janë në statusin e anuluar, për Francën. ” Në pikën 4 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit është kërkuar që produktet të jenë të rregjistruara në Angli, Zvicër, Kanada, Australi dhe SHBA (OE duhet të paraqesë certifikatën e regjistrimit të

produkteve biocide me agjent biologjik Bti ËG dhe Bti G, në një prej vendeve të Bashkimit Europian ose në Angli, Zvicër, Kanada, Australi, dhe SHBA të regjistruar në ECHA (Agjensia Evropiane e Kimikateve, organi më i madh për kimikatet në Evropë). Kemi dorëzuar dokumente (Çertifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, datë 12 Mars 2016) që vërtetojnë që produkti është i rregjistruar edhe në SHBA (perveç se në Europë). Fakti që ju nuk i konsideroni të dorëzuara sipas formës së kërkuar, nuk i bën ato dokumente apo përmbajtjen e tyre të pavlefshme. Kjo do të thotë që, kërkesa juaj që produkti të jetë rregjistruar në një prej atyre vendeve, është plotësuar nga ana jonë. Ne kemi dorëzuar një Vendim me vulë origjinale të Ministrisë Franceze, ku vërtetohet se produktet Aquabac 200 G dhe Aqubac DF 3000 janë të rregjistruara në Francë. Së shpejti do të bëhet edhe azhornimi i tyre në ëbsite-t përkatëse. Fakti që nuk janë azhornuar online, nuk e bën vendimin për rregjistrimin e tyre të palvefshëm. Në vazhdim, kemi sqaruar dhe paraqitur një komunikim të datë 24.09.2019, në të cilin jepen shpjegime të mëtejshme në lidhje me statusin actual të këtyre produkteve. Fakti që janë dorëzuar dy vendime origjinale, më firmë dhe vulë nga autoriteti kompetent, është e mjaftueshme për plotësimin e kërkesave tuaja sipas DST. Për sa më sipër, kjo arsye skualifikimi është e pavlefshme dhe si e tillë nuk qëndron.

5. Nuk jemi dakord me arsyen e pestë të skualifikimit sipas së cilës "5. Skeda teknike e dozatorit MMF është e gabuar. Dozatori i paraqitur nga ju nuk plotëson specifikimet teknike të cilat kërkojnë në DST e tenderit "shtojca 9", ku kërkohej se OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m². Skeda teknike e paraqitur nga ana e Pastrimi Silvio shpk është dozator mekanik i rregullueshëm (DOSAMATIC gr), e cila tregon qartësisht tek fusha e aplikimit të pajisjes e cila përdoret për produkte me formulime granule me doze (nga 2 gr 10 gr). ndërkohë që DST e kërkojnë për përdorim me formulim lëng deri në 1ml. Nuk përdoren kriteret e vecanta për kualifikim në lidhje me pajisjen Dozatore MMF dhe specifikimet teknike për Dozatorin për MMF." Autoriteti është bazuar në vogëlsira, që nuk i shërbejnë në vlerësimin të ofertës sonë në thelb. Shoqëria jonë e ka ofruar shërbimin e dezinfektimit gjatë viteve 2016-2018 (pra, për 3 vjet) dhe, gjatë këtyre viteve shërbimi është kryer me profesionalizëm dhe sipas specifikimeve teknike e kërkesave përkatëse. Vetë ISHP ka qenë kontrollues i shërbimit të ofruar nga ana jonë, nga ku mund të dëshmohej kryerja e shërbimit me sukses. Aktualisht, shoqëria jonë disponon të gjithë kapacitetin teknik, mjetet dhe makineritë e nevojshme për ofrimin e shërbimit sipas kërkesave e specifikimeve të DST. Fakti që KVA vlerëson se skualifikimi ynë duhet të bazohet mbi matjen në mililitra apo gr, për të vendosur nëse ne jemi të aftë për të ofruar këtë shërbim është absolutisht absurde. Shërbimi është ofruar me dozator, pa pasur problemin nëse matja do të bëhet në përqëndrimin 1ml/m² apo në dozën 2 gr. Në një arsye skualifikimi autoriteti bazohet në formën e paraqitjes së dokumentacionit duke e konsideruar atë të pasaktë dhe në një arsye tjetër skualifikimi, autoriteti thotë që duke qenë se matja e sasisë së produktit MMF është kërkuar të bëhet në ml, dozatori i operatorit është i pasaktë pasi e mat sasinë në gr. Ne do të bëjmë rregullimet përkatëse si dhe, kalibrimin (si një kërkesë e veçantë e DST), në mënyrë që të përputhet matja e përqëndrimit ndërmjet mililitrave dhe gramit, dhe këto dallime që Autoriteti i konsideron thelbësore, të eliminohen. Për sa më sipër, kjo arsye skualifikimi është e pavlefshme dhe si e tillë nuk qëndron.

6. Nuk jemi dakord me arsyen e gjashtë të skualifikimit sipas së cilës "6. Formulari i ofertës Shtojca 1 (Lot1) duhet të kishit deklaruar në pikën (1) dhe në pikën (2), me gërma dhe me numra

vetëm, shumatoren e çmimeve për njësi. Plotësimi i formularit nga ana juaj është bërë në kundërshtim me DST e tenderit, dhe Rekomandimit nr. 10419, datë 26.11.2018 të APP “Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër”. Formulari i Ofertës i dorëzuar nga ana jonë, është plotësuar në përputhje me Rekomandimin nr. 10419, datë 26.11.2018 si dhe, parashikimet e DST. Në paragrafin e parafundit të pikës II, të Rekomandimit nr. 10419, datë 26.11.2018 “Mbi përdorimin e Marrëveshjes Kuadër”, shprehet se: “Në këtë rast, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi, dhe për efekt krahasimi, edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim, nga autoriteti kontraktori ” Ofertimi nga ana jonë, është bërë me çmimet për njësi dhe është bashkëlidhur Preventivi me vlerat përkatëse për secilin zë të parashikuar dhe çmimin total. Ashtu siç është kërkuar Formulari i Ofertës në DST, ashtu është bërë dhe plotësimi nga ana jonë. Nuk është ndryshuar as formati dhe as zërat e tabelës së dhënë nga vetë Autoriteti. Në pikat 1 dhe 2, është shkruar: Çmimi total i ofertës sonë është dhe nuk është shkruar Çmimi total i shumatores së çmimeve për njësi është... Duke qenë se nuk ka një praktikë të unifikuar nga autoritetet kontraktore apo Udhëzime/ Rekomandime të APP për mënyrën ekzakte të plotësimit të Formularit të Ofertës, KVA nuk ka një bazë ligjore konkrete mbi të cilën e bazon vendimin e saj, vendim të cilin e konsiderojmë në kundërshtim me frymën dhe parimet e ligjit të prokurimit publik. Është vetë Autoriteti juaj i cili për të njëjtën procedurë përdor dy mënyra të ndryshme vlerësimi, dy standarde për sa i takon mënyrës së plotësimit të formularit të ofertës. Kjo për arsye se, shoqëria “Pastrime Silvio” ka marrë pjesë në procedurën me objekt “LOTI I : “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë ”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet në vlerë 16,689,581 lekë (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSh; Shumatorja e çmimeve njësi të shërbimeve të parashikuara për këtë lot është 53,801 (pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e një) lekë pa TVSh” me m. ref. REF-11178-02-28-2019, datë 25.03.2019 dhe Formulari i Ofertës është plotësuar nga ana jonë në të njëjtën mënyrë si në procedurën aktuale dhe jemi kualifikuar nga ana juaj (bashkëlidhur po ju dërgojmë Formularin e Ofertës së dorëzuar nga ana jonë për procedurën e sipërpërmendur). Pra, ju vetë si Autoritet Kontraktor, brenda një periudhe të shkurtër kohore, përdorni dy standarde të ndryshme vlerësimi. Ritheksojmë se, nuk ka një praktikë të unifikuar apo Udhëzime/Rekomandime të APP për mënyrën ekzakte të plotësimit të Formularit të Ofertës dhe Autoritete të ndryshme, përdorin praktika të ndryshme. Në disa raste, i njëjti Autoritet përdor praktika të ndryshme (si në rastin tuaj). Nuk mund të na skualifikoni pa baza praktike apo ligjore, aq më tepër kur dhe plotësimi nga ana jonë është bërë sipas modelit që keni kërkuar ju. Pra, plotësimi i Formularit të Ofertës është bërë në përputhje me Rekomandimin nr. 10419, datë 26.11.2018 të APP si dhe, DST-së. Vetë Autoriteti ka paraqitur modelin e gatshëm për plotësim nga operatorët ekonomikë dhe siç jemi shprehur më sipër, është kërkuar çmimi total i ofertës dhe jo çmimi total i shumatores së çmimeve për njësi. Ndërkohë, është plotësuar tabela me çmimet përkatëse për njësi, shumatorja e çmimeve për njësi pa tvsh (totali çmime njësi sipas Formularit të gatshëm të Autoritetit kontraktor) dhe shumatorja e çmimeve për njësi me tvsh (totali me tvsh). Për sa më sipër, kjo arsye skualifikimi është e pabazuar dhe si e tillë duhet të shfuqizohet.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dhe një komunikim të datës 24.09.2019 me CEO-n e kompanisë distributor të produkteve Aquabac për Europën, CERA SAS, ku i kemi përcjellë shqetësimin tonë për arsyen e skualifikimit nga procedura dhe përgjigjen e saj. Gjithashtu, znj. Aspirot ka

bashkëlidhur dy e-mail-e, komunikime të znj. Aspirot me përfaqësues të Ministrisë Franceze, ku i konfirmojnë se: Së pari, Vendimet në lidhje me aprovimin e produkteve AQUABAC 200G, AQUABAC XT dhe AQUABAC DF 3000 janë firmosur dhe se, dokumentet e vlerësimit dhe Vendimet për këto tre produkte janë postuar në R4BP dhe, Së dyti, në momentin që vendimet e aprovimit u firmosën në Gusht, janë informuar të gjitha Shtetet Anëtare të interesuara. Ata pra, janë në dijeni se janë marrë vendime të reja në Francë. Varet nga to nëse, do të presin publikimin në R4BP apo mos t'i ndryshoj në autorizimet e tyre të marketingut. Ata janë aktualisht në diskutime me ECHA-n për të ri-hapur "asetet" të cilat janë anuluar në R4BP në mënyrë që të azhurnohen. Shtete Anëtare të interesuara janë përfshirë gjithashtu në shkëmbimet që ata kanë pasur me ECHA-n për këtë çështje. Pra, i gjithë argumentimi juaj mbi verifikimet që keni bërë në faqet online të cituara (ECHA, ANSES dhe CERA), është i pavlefshëm. Autoriteti mund të komunikonte me Ministrinë Franceze për tu interesuar për këtë produkt për të cilin ne kemi paraqitur dy vendime me firmë dhe vulë origjinale (ndryshe nga sa pretendohet se nuk janë paraqitur), por nuk e ka bërë këtë gjë duke u mjaftuar me disa klikime online përkundrejt dy vendimeve zyrtare, të firmosura dhe vulosura nga Ministria Franceze”

II.5.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1176/29 Prot. datë 03.10.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimesues “Pastrime Silvio” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

”[...] 1. Përsa i përket pretendimit se: keni dorëzuar dokumente origjinale të dy vendimeve: “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. AMM: FR2019-0101” për produktin Aquabac DF 3000, firmosur dhe vulosur nga Drejtoresha e Përgjithshme e Deleguar (Dr. Caroline SEMAILLE) dhe vendimi i dytë “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. AMM: FR-2019-0099 PËR PRODUKTIN AquaBac 200G, firmosur dhe vulosur nga Drejtoresha e Përgjithshme e Deleguar (Dr. Caroline SEMAILLE) e Agjensisë Franceze të Shëndetit dhe Sigurisë së Ushqimit, Mjedisit dhe Punësimit (ANSES), sqarojmë se këto dy dokumente nuk janë origjinalë ose njësi me origjinalin. Dokumentet e sipërcituar janë paraqitur shoqëruar vetëm me vërtetimin e përkthimit nga gjuha franceze. Nga shqyrtimi i dokumentacionit edhe të përkthimit të tij, rezulton se në të është shënuar qartësisht në kapitullin 1.2 "emri dhe adresa e mbajtësit" të këtij dokumentacioni, i cili është CERA SAS, me adresë: 16 Rue de Sain -Petersbur 75008 Paris. Përsa më sipër dokumenti i paraqitur nga ana juaj nuk mund të jetë origjinal, i poseduar aktualisht nga ju, sepse dokumentacioni origjinal qendron tek mbajtësi i tij dhe nga na juaj nuk është bërë as njësimi me origjinalin. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. KshA-ja verifikoi edhe në datën e sotme 03.10.2019 në ëbsite e ANSES <https://ëë.anses.fr/en/decisions/biocide>, dhe produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, kanë ende certifikimet e regjistrimeve të datës 30 qershor 2016 (30 June 2016), të cilat janë anuluar që prej datës 18 Qershor 2018. Gjithashtu u verifikua edhe në ëbsite-in e CERA <http://cera-biocide.fr/aquabac-df3000/> dhe <http://cera-biocide.fr/aquabac-200g/>, në të cilin shfaqen vetëm regjistrimet e vjetra të produkteve të mësipërme për vitin 2016. Bashkëlidhur do

të gjeni dokumentet për verifikimet e kryera. Për sa më sipër, pretendimi i OE "PASTRIME SILVIO" nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

2. Përsa i përket pretendimit se: Certifikata nga Agencia e Mbrojtjes së Mjedist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dt. 12 Mars 2016, për produktin me përmbajtje të Bti BMP 144 DF 3000 me nr. rregjistrimi 62637-14 dhe Bti BMP 144 (200 G) me nr. rregjistrimi 62637-3, është dorëzuar si dokumentacion shtesë, sqarojmë se nga shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e KSHA, rezulton se ky dokument nuk është i rregullt, pasi është paraqitur vetëm shoqëruar me vërtetim përkthimi. Edhe vetë Operatori Ekonomik, në ankesën e tij shpjegon se ky është një dokument shtesë dhe e pranon që nuk është një dokument origjinal ose njësi me origjinalin. Ky dokument ka të njëjtën formë paraqitje si edhe dokumentat e tjera të sipërcituara prandaj konstatojmë se edhe ky dokumentacion nuk është origjinal ose njësi me origjinalin dhe nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8 ku në mnd të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e te paskakta konsiderohen si kushte për skualifikim. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Për sa më sipër, pretendimi i OE "PASTRIME SILVIO" nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

3. Përsa i përket pretendimit se: Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për AQUABAC 3000DF, është origjinal ose njësi me origjinalin dhe se shtesat janë bërë në fund të etiketave me udhëzim të kompanisë distributore, për ta përshtatur për t'u përdorur në tregun shqiptar, sqarojmë se Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për AQUABAC 3000DF, është paraqitur vetëm me vërtetim të përkthimit dhe jo origjinal ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2019-03-10; data e prodhimit mars: 2019 dhe data e skadimit Mars 2021. (si dhe janë shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (të dhëna këto të cilat nuk janë në dokumentin në gjuhën angleze). Dokumenti (solucion Biologjik kundër mushkonjave) (etiketa/katalogu) për AQUABAC 200G, është paraqitur vetëm me vërtetim përkthimi dhe jo origjinali ose njësi me origjinalin. Në dokumentin e mësipërm në përkthim janë vendosur të dhëna shtesë në lidhje me numrin e serisë: 2018-12-01; data e prodhimit: Dhjetor 2018 dhe data e skadimit: Dhjetor 2021. (si dhe janë shtuar shënimet në lidhje me importuesin, distributorin dhe prodhuesit, (të dhëna këto të cilat nuk janë në dokumentin në gjuhën angleze). Pra në dokumentin e përkthyer janë shtuar shënime të cilat nuk janë në dokumentet në gjuhën angleze. Dokumenti i paraqitur prej jush është nuk është njësi me origjinalin ose origjinal dhe si i tillë nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8 ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskata konsiderohen si kushte për skualifikim. Për sa më sipër, pretendimi i OE "PASTRIME SILVIO" nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

4. Përsa i përket pretendimit se: Skedat teknike të Aquabac 200 g dhe Aquabac DF 3000 të vitit 2018, nuk duhet të noterizohen pasi dokumenti nuk përmbush kushtet ligjore për t'u njësuar me origjinalin dhe se ndryshimet e rishikimet në këtë dokumentacion i ka bërë kompania

distributore për ta përshtatur me kërkesat e tregut ku ajo vepron, sqarojmë se: Në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca m. 8, në paragrafin e fundit të saj cilësohet se: të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre. Në lidhje me pretendimin se skedat teknike publikohen online dhe nuk është e nevojshme njësi me origjinalin OE mund të kishte paraqitur ankesë gjatë fazës së pritjes së ofertave bazuar në Nenin 63 lika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku të kërkonte modifikimin e DST-ve. Duke qenë se Skedat teknike të Aquabac 200 g dhe Aquabac DF 3000 të vitit 2018 nuk janë dokumenta njësi me origjinalin, ose origjinale, dokumenti nuk është i saktë, që e cila përbën kusht s’kualifikimi. Fishat teknike të paraqitura nga CERA, të vitit 2019 (edhe pse Fishat teknike të vitit 2019 nuk janë hartuar nga kompania prodhuese), nuk janë dokumenta njësi me origjinalin, ose origjinale, dhe si të tillë nuk përmbushin kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8 ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskata konsiderohen si kushte për skualifikim. Autoriteti kontraktor, duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 53/3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Për sa më sipër, pretendimi i OE “PASTRIME SILVIO” nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

5.Përsa i përket pretendimit, ku OE nuk është dakord me arsyet e skualifikimit se nuk ka paraqitur asnjë informacion apo dokumentacion në lidhje me rregjistrimin në ECHA të produkteve Biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000 " duke pretenduar se Certifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dt. 12 Mars 2016, për produktin me përmbajtje të Bti BMP 144 DF 3000 me nr. rregjistrimi 62637-14 dhe Bti BMP 144 (200 G) me nr. rregjistrimi 62637-3, e dorëzuar si dokumentacion shtesë (e shpjeguar nga vetë Operatori ekonomik në Ankese) dhe dokumentat “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. AMM: FR-2019-0101” për produktin Aquabac DF 3000, dhe “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. AMM: FR-2019-0099 për produktin AquaBac 200G, të Agjencisë Franceze të Shëndetit dhe Sigurisë së Ushqimit, Mjedisit dhe Punësimit (ANSES) plotësojnë kërkesën për paraqitjen e regjistrimit të produktit në ECHA sqarojmë se: Pas shqyrtimit të pretendimit të mësipërm KSHA-ja konstatoi se: Certifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dt. 12 Mars 2016, për produktin me përmbajtje të Bti BMP 144 DF 3000 me nr. rregjistrimi 62637-14 dhe Btzi BMP 144 (200 G) me nr. rregjistrimi 62637-3, 9; dorëzuar si dokumentacion shtesë (e shpjeguar nga vetë Operatori ekonomik në Ankese) nuk është dokument origjinal apo njësi me origjinalin. Dokumentet “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. AMM: FR-2019-0101” për produktin Aquabac DF 3000, dhe “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. AMM: FR-2019-0099 për produktin AquaBac 200G, të Agjencisë Franceze të Shëndetit dhe Sigurisë së Ushqimit, Mjedisit dhe Punësimit (ANSES) nuk provojnë regjistrimin e produkteve të sipërpërmendura në ECHA. Për sa më sipër vërtetohet që regjistrimi në ECHA

nuk është kryer edhe në shpjegimet që jepni në komunikimin tuaj me e-mail të datës 24.09.2019 me kompaninë distributore CERA, ku vërtetohet plotësisht fakti që produktet nuk janë regjistruar në Regjistrin për Produktet Biocide (R4BP) të ECHA, por janë në proces diskutimi. KSHA përsëri bëri një verifikim në datën 03.10.2019, në lidhje me regjistrimin në ECHA të produkteve Biocideve Aquabac 200 G dhe Aquabac DF 3000, ku u verifikua përsëri në sistemin e ECHA dhe konfirmohet se produktet e ofruara sipas ëbsite [htt-s://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products](http://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products) janë në statusin e anuluar, për Francën, për AquaBac 200G, ndërsa për produktin Aquabac DF 3000 është në statusin e anuluar si për Francën ashtu edhe për Spanjën. AK-ja, ka kërkuar në DST, Kriteret e veçanta për kualifikim se "OE duhet të paraqesë certifikatën e regjistrimit të produkteve biocide me agjent biologjik Bti ËG dhe Bti G, në një prej vendeve të Bashkimit European ose në Angli, Zvicër, Kanada, Australi, dhe SHBA të regjistruar në ECHA (Agensia Evropiane e Kimikateve, organi më i madh për kimikatet në Evropë)". Për sa më sipër ju nuk vërtetoni që produkti është i regjistruar në ECHA. Autoriteti kontraktor, duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në zbatim të nenit 53/3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen sitë papranueshme. Për sa më sipër, pretendimi i OE "PASTRIME SILVIO" nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

6. Përsa i përket pretendimit se Autoriteti Kontraktor është bazuar në vogëlsira lidhur me Skeda teknike e Dozatorit MMF, ju sqarojmë se pas shqyrtimit të dokumentacionit KSHA-ja konstaton se Dozatori MMF shoqëruar me Skeden teknike është i gabuar. Dozatori i paraqitur nga ana e OE, nuk plotëson specifikimet teknike të cilat kërkohen nga DST e tenderit "shtojca 9", ku kërkohet se "OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m2. Skeda teknike e paraqitur nga ana juaj është dozator mekanik i rregullueshëm (DOSAMATIC gr), e cila tregon qartësisht tek fusha e aplikimit të paisjes, e cila përdoret për produkte me formulime granul me doze (nga 2gr -10 gr), pra KSHA konstatoi se nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, në lidhje paisjen Dozatore MMF. Autoriteti kontraktor, duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 53/3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Për sa më sipër, pretendimi i OE "PASTRIME SILVIO" nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

7. Përsa i përket pretendimit se Formulari i ofertës i dorëzuar nga ana juaj, është dorëzuar në përputhje me Rekomandimin nr. 10419, datë 26.11.2018 si dhe parashikimet e DST, sqarojmë se Formulari i ofertës Shtojca 1 (Lot 1) duhet të kishit deklaruar në pikën (1) dhe në pikën(2), më gërma dhe me numra vetëm shumatoren e cmimeve për njësi. Plotësimi i formularit nga ana juaj është bërë në kundërshtim me DST e tenderit, dhe Rekomandimit nr. 10419 datë 26.11.2018 të APP "Mbi nërdorimin e marrëveshjes kuadër" si dhe me pikën 7.3 të udhëzimit nr. 6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar ku në paragrafin e fundit përcaktohet se: Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet

nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përlllogaritur, për çdo artikull apo shërbim, nga autoriteti kontraktor. Për më tepër KSHA, konstatoi se OE “PASTRIME SILVIO” sh.p.k., ka dhënë dy vlera të ndryshme për sa i përket çmimit total të ofertës së tyre, konkretisht tek shtojca 1 “Formulari i ofertës” në vlerën prej prej 7,728,840 lekë pa TVSh, ndërsa tek preventivi bashkëlidhur vlerën prej 7,657,980 lekë pa TVSh. Sa më sipër, si dhe referuar pikës 1 të Nenit 51 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji. Gjithashtu në zbatim të pikës 2 të po këtij neni një ofermësi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohet që të ndër marrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën. Për sa më sipër, pretendimi i OE “PASTRIME SILVIO” nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet. [...]”

II.5.3. Në datën 11.10.2019, operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Fatos Lashi” p.f., për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“1. Fatura doganore më dt 04/05/2016 me numër referimi 431 shoqëruar me faturat me nr134 datë 22/04/2016), Vërtetimi I njësisë së kopjes me origjinalin me nr 866 Rep (nuk shpjegon dokumentin që është noterizuar njësi me origjinalin sipas nenit 129 të ligjit 110/2018 “për noterinë) Dokumenti është I pasaktë si njësi me origjinalin. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është I saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi

2. Vërtetimi njësi me origjinalin me nr Rep 2776 datë 05-09-2019 ka noterizuar sipas shpjegimit të noterit vetëm “Vërtetimin e firme me nr rep 710 datë 19-03-2019, notere Rudina Hoxhaj. Dokumentat doganore me nr 431 datë 04/05/2016 dhe faturat shoqëruese me nr134 datë 22/04/2016 e Spry team, bashkëlidhur këtij vërtetimit me nr 2776 Rep, nuk janë njësuar me origjinalin dhe nuk janë origjinale. Për sa më sipër, nuk janë njësuar me origjinalin sipas Nenit 129 të ligjit nr 110/2018” për noterinë. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s’kualifikimi.

3. Dokumenti “konformitet I dosjes lidhur me substancën active....” Dt 08/09/2016, është dokument kopje dhe jo njësi me origjinalin (është përkthyer edhe nga përkthyesja përkatëse që është kopje).

4. Autorizim nga Distributori Cera më datë 13/08/2019 dhe marrëveshja përkatëse midis distributorit CERA dhe prodhuesit Becker Mikrobial products nuk është njësuar me origjinalin. Vërtetimi I noterit (I cili bashkëlidh keto dokumenta) me nr 2662 rep datë 29/08/2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm për” Vërtetimin e firmës nr 2080 rep datë 29-08-2019 nga notere Rudina Hoxhaj” dhe “vërtetimin e firmës nr 2089 rep, datë 28-08-2019 notere Rudina Hoxhaj”.

Noterizimi nuk është kryer konform nenit 129 të ligjit nr 110/2018. Nuk vërtetohet se është njësi me origjinalin dokumentat Autorizimi I distributorit dhe marrëveshja midis distributorit dhe prodhuesit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi

5. Cerifikata e rregjistrimit në EPA për produktin Aquabac 200G dhe Etiketa përkatëse nuk është njësuar me origjinalin, bazuar në nenin 129 të ligjit nr 110/2018. Njësia me origjinalin paraqitur nga ana juaj me nr.2663 datë 29-08-2019 vërtetohet njësi me origjinalin vetëm të "Vërtetim firme 2091 rep, dt 29/08/2019 notere Rudina Hoxhaj" dhe "Vërtetim firme 2088 rep, dt 29/08/2019" notere Rudina Hoxhaj, pra është njësuar me origjinalin vetëm vërtetimi i përkthimit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi

6. Cerifikata e rregjistrimit në EPA për produktin Aquabac DF3000 dhe Etiketa përkatëse nuk është njësuar me origjinalin, bazuar në nenin 129 të ligjit nr 110/2018. Njësia me origjinalin paraqitur nga ana juaj me nr.2664 datë 29-08-2019 vërtetohet njësi me origjinalin vetëm të Vërtetim firme nr. 2090 rep, dt 29/08/2019 notere Rudina Hoxhaj dhe Vërtetim firme nr 2077rep, dt 28/08/2019 notere Rudina Hoxhaj, është njësuar me origjinalin vetëm vërtetimi i përkthimit. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi

7. Dokumenti i të dhënave të sigurisë (skeda teknike) për biocidet AQUABAC DF 3000 të vitit 2018, janë shoqëruar vetëm me vërtetim përkthimi 2087 Rep datë 29/08/2019, dhe AQUABAC 200G I shoqëruar vetëm me vërtetim përkthimi me nr 2086 datë 29/08/2019 dhe këto dokumenta nuk janë origjinale ose të njësuar me origjinalin. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi

8. Deklarata për përbërës aktiv Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, nga CERA drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe dokumentat shoqëruese, nuk është vërtetuar njësia me origjinalin por është vërtetuar njësi me origjinalin sipas përshkrimit të noteres "Vërtetim firme me nr 1409 datë 17/06/2019 të Rudina Hoxhaj", noterizimi nuk është në bazë të nenit 129 të ligjit 110/2018 "Për noterinë". Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi

9. Dokumenti "Vendim lidhur me kërkesën për Autorizim për tregëtimin e produktit bioacid", lëshuar nga ANSES datë 19/08/2019 për Aquabac DF 3000 me nr FR 2019-0101, dhe Aquabac 200 G me nr. FR 2019-0099., nuk është origjinale ose njësi me origjinalin. Është kryer vetëm "vërtetim firme i përkthyeses me nr 2116 datë 02/09/2019". Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi

10. Skeda teknike e Dozatorit MMF është e gabuar sespe nuk plotëson specifikimet teknike në DST e tenderit. OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m2. Me dozatorin e paraqitur nga ana juaj nuk mund të verifikohet saktësisht matja 1ml.

11. Nuk ka paraqitur asnjë dokument apo informacion për rregjistrimin tek ECHA te produkteve Biocide për Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000. Nga verifikimet ne ëeb site e ECHA, u

verifikua qe produkti Aquabac 200G eshte ne statusin e anuluar (cancelled); dhe Aquabac DF 300 eshte po gjitashu ne statusin e anuluar (cancelled)(ne France).

12. Formulari i ofertës është gabim nuk është paraqitur sipas DST-ve per Lot.1 Për sa më sipër OE Fatos Lashi pf, nuk ploteson kriteret e veçanta për kualifikim(pika 2 e shtojces 8); pika 3.3 kapaciteti teknik, pika 2 (për paisjen aparat mjegullues dhe pompe me presion të lartë, (bazuar ne modifikimet e DST-ve), dhe per faturat e blerjes së atomizatorit të granulave dhe atë për lëng), pika 3 (shkronja a dhe b), pika 4,5 dhe formulari i ofertë, I cili nuk janë të saktë sipas DST-ve (duke përfshirë modifikimet). Dokumentat nuk janë origjinale ose njësi me origjinalin, sipas paragrafit të fundit të shtojcës 8. Ne lidhje me dokumentat e paraqitura për produktet biocide (aquabac 200G dhe aquabac DF 3000), te paraqitura nga OE Fatos lashu verifikoi ne ëeb sitet si me poshte me daten 23/09/2019: • site ECHA në lidhje me rregjistrimin e produkteve biocide në lidhje me produktet, Aquabac 200 dhe Aquabac DF 3000 <https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0008703-0000/authorisationid> dhe <https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0009287-0000/authorisationid>, rezultuan me statusin anuluar (cancelled) për Francën nga i cili eshte paraqitur dokumentacioni. • site e distributori CERA, lidhje me produktet, Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000 <http://cera-biocide.fr/aquabac-df3000/> dhe <http://cera-biocide.fr/aquabac-200g/>, vazhdojne te jenë të paraqitur vetëm rregjistrimet FR -2016-0054 për AQUABAC DF 300 dhe FR -2016-0053 Aquabac200G, si dhe skedat teknike jane end te vitit 2016. • site ANSES ne lidhje me rregjistrimin e biocideve. Nga verifikimet rezultuan se produktet Aquabac DF 3000 ka rregjistrimin FR2016-0054 dhe Vendimi i publikuar ne ëeb site eshte ende i anuluar. Gjitashtu edhe produkti Aquabac 200G, i cili ka rregjistrimin FR 2016-0053, Vendimi i publikuara eshte i anuluar. Vendimet e Anses te publikuara jane te anuluar qe prej dates 29 June 2018. https://www.anses.fr/en/system/files/biocides/decisions/AQUABACDF3_PB-13-00424_BAMM_D.pdf dhe https://www.anses.fr/en/system/files/biocides/decisions/AQUABAC200G_PB-13-00422_BAMM_D.pdf

II.6.1.Në datën 30.09.2019, operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe ka ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik i kualifikuar “NRG” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Me sa vërehet në citim e mësipërm, me vendim marrjen e saj ISHP ka marrë tagrat e Ministrisë së Drejtësisë dhe të noterit publik. Nga vetë konstatimi i AK nuk rezulton asnjë nga dokumentet e kërkuara dhe të paraqitura nga OE që të jetë i pa noterizuar. Nëse mendon se procedura e noterizimit nuk është e saktë, ka vetëm një mundësi të njoftojë/të ankohet pranë Ministrisë së Drejtësisë ashtu siç parashikohet në nenin 29. Dokumenti i cilësuar ne pikën 3. të konstatimeve nga AK: “Dokumenti “konformitet i dosjes lidhur me substance active... ”Dt 08/09/2016, eshte dokument kopje dhe jo njesi me origjinalin (eshte perkthyer edhe nga perkthyesja perkatese qe eshte kopje). është një dokument sqarues që të ndihmojë AK në shqyrtimin e ofertës. Por AK me shumë “dashamirësi” e cilëson si një dokument të kërkuar në DST. Meqenëse nuk është dokument i kërkuar nga AK nuk duhej të ishte marrë në konsideratë gjendja e tij.

Pretendohet se “Skeda teknike e Dozatorit MMF eshte e gabuar sepse nuk ploteson specifikimet teknike ne DST e tenderit, OE duhet te disponoje Dozator per leng, i cili duhet te mundesoje matjen e sasise se duhur ne mililitra te filmit monomolecular ne formulimin leng, perperdorim ne perqendrimin 1ml m2. Me dozatorin e paraqitur nga ana juaj nuk mund te verifikohet saktesisht matja 1ml. të shqyrtohet edhe njëherë ky fakt sepse skeda teknike e dozatorit i permban të dyja shkallëzimet për të matur me të dyja njësitë sipas gjendjes së lëndës që duhet të matet.

Në lidhje me pretendimin se OE: “ Nuk ka paraqitur asnje dokument apo informacion per rregjistrimin tek ECHA te produkteve Biocide per Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000. Nga verifikimet ne  eb site e ECHA, u verifikua qe produkti Aquabac 200G eshte ne statusin e anuluar (cancelled) dhe Aquabac DF3000 eshte po gjithashtu ne statusin e anuluar (cancelled). ju b ejm e me dije se: arsyetimi juaj nuk qendron dhe nuk eshte ne perputhje me  far e kerkohet ne DST. AK nuk ka kerkuar te paraqitet asnje dokument nga ECHA ne DST, por qe lenda baze e produkteve te jete te regjistruar ne ECHA. Per te dy produktet ne kemi paraqitur regjistrimin e ri ne France ne muajin Gusht 2019, i cili eshte dokument mese i mjaftueshem dhe i domosdoshem ne perputhje me kerkesat e DST dhe qe ne e plotesojsme. Duke qene se ju i jeni referuar  ebsite te ECHA mbi regjistrimin e ketyre produkteve dhe ju ka rezultuar se ato jane te c’rregjistruara ne France, sic shpreheni ne piken 11, nenpika 1, nenpika 2 dhe nenpika 3; kjo eshte plotesisht e pajustificueshme dhe e paarsyetueshme. Ne ju kemi vene ne dijeni regjistrimet e reja ne France te dates 19.08.2019 per produktet AquaBac DF3000 me numer reference FR-2019-0101 dhe AquaBac 200G me numer reference FR-2019-0099. Perse nuk i jeni referuar ketij dokumenti te fundit dhe me te ri, por nuk e merrni parasysht ne menyre diskriminuese dhe i referoheni cfare ka aktualisht ne ECHA, e cila akoma nuk e ka update regjistrimet e reja sepse kerkohen kohe administrative per kete. CERA dhe produktet e saj se bashku me lenden aktive jane te regjistruara ne ECHA qe en daten 16 Dhjetor 2016 (referuar dokumentave bashkengjitur), dhe vazhdojne te jene te regjistruara edhe ditën e sotme ku eshte bere marrja dhe shkarkimi i ekstrakteve te dokumentave nga  ebsite ECHA bashkengjitur. Perse ne asnej rast Ju ne menyre diskriminuese nuk i referoheni ketij dokumenti te listes se lendeve aktive te miratura dhe regjistruara ne ECHA? Dhe mbi te gjitha Certifikatat e Regjistrimit te Produkteve Aquabac DF3000 dhe Aquabac 200G me Vule te Arte nga EPA (American Environmental Protection Agency), eshte efektive dhe ne asnje rast nuk e keni marre parasysht ne menyre diskriminuese dhe favorizuese per kompanine NRG e cila eshte futur ne tender me produktet e Sumitomo Valent, por i referoheni vetem regjistrimeve te vjetera te produkteve te CERA ne ECHA; Jane tejet te mjaftueshme Certifikatat e reja te Regjistrimit ne France nga Ministria dhe Institucionet Kompetente Franceze per kete pune per produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 2006, si edhe Certifikates se Regjistrimit me Vule te Arte nga EPA (American Environmental Protection Agency) per keto dy produkte. Bashkengjitur gjeni edhe dokumentat mbeshtetes te shkarkuar ne  ebsite e ECHA ditën e sotme, ku tregohet regjistrimi i lendes aktive ne ECHA qe ne daten 16 Dhjetor 2016, si edhe ekstrakt i regullores 528/2012 neni 54 qe tregon per ekuivalencen teknike te lendeve aktive: “Kur dy lende aktive jane pothuajse te njejta ose identike, ato regjistrohen si nje e vetme”. Shkresa e ANSES verteton plotesisht kete fakt (ju lutem gjejeni bashkengjitur, gjendet dhe e perktheyr dhe e noterizuar ne dokuementacionin e dorezuar kur eshte aplikuar per ne tender per Lot 4). REGULATION (EU) No 528/2012 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 22 May 2012 concerning the making available on the market and use of biocidal products. Linku perkates

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011L0078&from=EN>
Prandaj, CERA eshte regjistruar ne ECHA me lende aktive *Bacillus thuringiensis subsp. israelensis*. Serotipi H14. Strain AM-65-52, sepse edhe kompania qe ka kete lende te ngjashme ka produkte te tjera me emertese tjeter. Dhe per arsye tregtimi shtami yne eshte shenaur MBP-144, e perserisim vetem per arsye tregtimi dhe ndryshim emri tregtar, sepse s'mund te kete te njejtin emer shtami si produktet e Valent Sumitomo. Ky fakt i mesiperem, verteton katerciperisht ne menyre te pakundershtueshme se produktet dhe lenda aktive e CERA jane te regjistruara ne ECHA qe prej 16 Dhjetor 2016 dhe vazhdojne edhe sot e kesaj dite te jene te regjistruar dhe te lejuara per tu tregtuar ne Evrope, treguar nga dokumenti bashkengjitur, ekstrakt nga lista e lendeve aktive dhe e kompanise qe i kane mbrojtur dhe dorezuar ne EHCA ne daten 30 Gusht 2019 ne perputhje me Article 95 Lista. Linku perkates:

http://echa.europa.eu/documents/10162/27434452/art_95_ist_en.pdf/c752c5ae-358c-e84b652a-fb98106dfe8e

Perse per produktin Aquabac 200G ju nuk i referoheni  esite te ECHA? Sepse ky produkt eshte i regjistruar dhe lejuar ne Itali, Belgjike dhe Greqi, kurse Aquabac DF3000 eshte i regjistruar dhe autorizuar ne Itali. Dhe se fundimi edhe ne France. Megjithate, perpos kesaj, mjafton vetem Certifikata e Regjistrimit te Produkteve ne EPA me vule te arte dhe cdo gje eshte ne rregull sipas kerkesave te DST dhe ne perputhje me urdherin e ministrit Nr. 202 te dates 23.05.2014 per tregtimin e produkteve biocide ne Shqiperi. Perse i referoheni dokumentave dhe  esite te ANSES si ne piken 11, nenpika e TRETE ku jane regjistrimet e vjetera te anuluar. Keto regjistrime jane qe ne vitin 2016, por Ju nuk merrni parasysh dhe nuk i konsideroni fare dokumentacionin e ri dhe regjistrimet e reja te dala zyrtarisht nga ANSES France qe mbajne daten per produktet AquaBac DF3000 me numer reference FR-2019-0101 dhe AquaBac 200G me numer reference FR-2019-0099??? Perse i referoheni  esite te CERA qe ka regjistrimet e vjetera qe ne vitin 2016 si ne piken 11, nenpika e DYTE, ndersa nuk merrni parasysh dhe nuk e konsideroni fare dokumentacionin e ri dhe regjistrimet e reja te dala zyrtarisht nga ANSES France per CERAn, qe mbajne daten per produktet AquaBac DF3000 me numer reference FR-2019-0101 dhe AquaBac 200G me numer reference FR-2019-0099??? Perse i referoheni  esite te ECHA qe ka regjistrimet e vjetera si ne piken 11, nenpika e PARE ku jane regjistrimet e vjetera qe ne vitin 2016, ndersa Ju nuk merrni parasysh dhe nuk e konsideroni fare dokumentacionin e ri dhe regjistrimet e reja te dala zyrtarisht nga ANSES France per CERAn, qe mbajne daten per produktet AquaBac DF3000 me numer reference FR-2019-0101 dhe AquaBac 2006 me numer reference FR-2019-0099???

Pretendoni, se : Formulari ofertes eshte gabim dhe nuk eshte paraqitur sipas DST-ve per Lot I", ky pretendim i Ak mesa duket eshte ngritur vetem me leximin e veleres se totalit te ofertes, Ju sqarojme se ne zbatim te LPP dhe vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, jemi para rastit te nje gabimi aritmetik i cili duhet te korrigojhet meqenese ka ardhur nga nje gabim njerezore nga ana jone. Nese ka mosperputhje ndermjet cmimit per njesi dhe cmimit total, e cila del nga shumezimi i cmimit te njesis me sasine, cmimimi i njesis mbizoteron dhe cmimi total korrigojhet ne baze te tij. Ne rastin konkret oferta jone nuk duhet te refuzohet sepse eshte me e ulet se totali i paraqitur ne pjesen hyrese te ofertes, te cilen ju keni konsideruar ne vleresimin tuaj"

II.6.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1176/32 Prot. datë 04.10.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

”[...] 1. Përsa i përket pretendimit se në vërtetimin me të cilat shoqërohen dokumentet e noterizuara, cilësohet "Njësia është kopje e njëjtë me dokumentacionin origjinal", pas shqyrtimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. sqarojmë si më poshtë lidhur me secilin dokument të cituar në ankesën tuaj: Për faturën doganore të datës 04.05.2016 me numër referimi 431, shoqëruar me faturat me nr. 134, datë 22.04.2016, vërtetimi i njësisë së kopjes me origjinalin me nr. 866 Rep nuk cilëson cili është dokumenti origjinal që është noterizuar si më njësi më të, sipas nenit 129 të ligjit 110/2018 “Për nolerinë” dhe udhëzimin nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve noteriale si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar. Dokumenti i paraqitur prej jush (fatura doganore e datës 04.05.2016 me numër referimi 431, shoqëruar me faturat me nr. 134, datë 22.04.2016) është i pasaktë si njësi me origjinalin dhe nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8, ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskatë konsiderohen si kushte për skualifikim. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në vërtetimin e njësisë me origjinalin me nr. 2776 Rep, datë 05.09.2019, sipas shënimit të noterit është noterizuar vetëm “Vërtetim firme Nr. Rep 710. dt 19-03-2019, Notere Rudina Hoxhaj ”, ndërsa dokumentet doganore me nr. 431, datë 04.05.2016 dhe faturat shoqëruese me nr. 134, datë 22.04.2016 e Spray team, bashkëlidhur vërtetimit me nr. 2776 Rep, nuk janë origjinale apo njësi me origjinalin, sipas nenit 129 të ligjit 110/2018 "Për nolerinë " dhe udhëzimin nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve noteriale si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar. Dokumentet e paraqitur prej jush (dokumentet doganore me nr. 431, datë 04.05.2016 dhe faturat shoqëruese me nr. 134, datë 22.04.2016 e Spray team) janë të pasaktë si njësi me origjinalin dhe nuk përmbushin kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8, ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskakt konsiderohen si kushte për skualifikim. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Dokumenti “Konformiteti i dosjes lidhur me substancën aktive...” i datës 08.09.2016 është kopje dhe jo njësi me origjinalin. Ky dokument i paraqitur prej jush, në faqen e parë të tij ka një vulë me shënimin copie, paraqitur në imazhin më poshtë). Vërtetimi i njësisë me origjinalin paraqitur nga ana juaj me nr. 2664 Rep, datë 29.08.2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm "Vërtetim firme nr. 2090 Rrep, dt 29-08-2019 nga notere Rudina Hoxhaj" dhe “Vërletim firme nr. 2077 Rep, dt 28-08-2019 nga notere Rudina Hoxhaj”, pra është njësuar me origjinalin vetëm vërtetimi i përkthimit, ndërsa Certifikata e rregjistrimit në EPA për produktin

Aquabac DF3000 dhe Etiketa përkatëse nuk janë dokumente origjinalë ose të njësuar me origjinalin, në përputhje me nenin 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" dhe udhëzimin nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve noteriale si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", i ndryshuar. Dokumenti i paraqitur prej jush (Cerifikata e rregjistrimit në EPA për produktin Aquabac DF 3000 dhe Etiketa përkatëse) është i pasaktë si njësi me origjinalin për dokumentin e paraqitur dhe nuk përmbushi kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8, ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskam konsiderohen si kushte për skualifikim. Dokumenti i të dhënave të sigurisë (skeda teknike), përkatësisht për biocidin AQUABAC DF 3000 të vitit 2018, është shoqëruar vetëm me vërtetim përkthimi nr. 2087 Rep, datë 29.08.2019 dhe për biocidin AQUABAC 200G është shoqëruar vetëm me vërtetim përkthimi me nr. 2086 Rep, datë 29.08.2019 dhe këto dokumente nuk janë origjinale ose kopje të njësuar me origjinalin duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8, ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskata konsiderohen si kushte për skualifikim. Vërtetimi i njësisë me origjinalin paraqitur nga anajuaq me nr. 2790 Rep, datë 06.09.2019 vërteton njësi me origjinalin vetëm dokumentin "Vërtetim firme me nr. 1409 Rep. datë 17-06-2019 nga notere Rudina Hoxhaj ", ndërsa Deklarata për përbërësit aktiv Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, nga CERA drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe dokumentet shoqëruese nuk janë origjinale apo njësuar me origjinalin, në bazë të nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë " dhe udhëzimin nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve noteriale si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", i ndryshuar. Nga verifikimi edhe në këtë dokument të paraqitur nga juve, (të dërguara nga (ZERA), në lidhje me rregjistrimet në ECHA i referohet, infomacionit nga ëbsite., ku shpjegon se ky produkt, është i anuluar për Francën dhe do të rinovohet ne France nga muaji Korrik 2019. Por ky produkt ka ende statusin e paregjistruar në informacionet regjistrimeve të ECHA (të cilat i gjeni bashkëlidhur), madje është anuluar edhe për Greqinë, e cila në dokumentin tuaj paraqitet si aktive. Dokumentet e paraqitura prej jush (Deklarata për përbërësit aktiv Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, nga CERA drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe dokumentet shoqëruese) nuk përmbushin kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8, ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë: origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskata konsiderohen si kushte për skualifikim. Së fundi, dokumenti "Vendim lidhur me kërkesën për Autorizim për tregëtimin e produktit bioacid", lëshuar nga ANSES, më 19.08.2019 për Aquabac DF 3000 me nr FR 2019-0101, dhe Aquabac 200 G me nr FR 2019-0099 është shoqëruar vetëm me vërtetimin e firmës së përkthyeses me nr. 2116 datë 02-09-2019. Nga shqyrtimi i dokumentacionit edhe të, përkthimit të tij, rezulton se në të është shënuar qartësisht në kapitullin 1.2 "emri dhe adresa e mbajtësit" të këtij dokumentacioni, i cili është CERA SAS, me adresë: 16 Rue de Sain -Petersbur 75008 Paris. Përsa më sipër dokumenti i paraqitur nga ana juaj nuk mund të jetë origjinal, i poseduar aktualisht nga ju, sepse dokumentacioni origjinal qendron tek mbajtësi i tij dhe nga na juaj nuk është bërë as njësimi me

origiinaiin; Është detyrim ligjor i subjektit ofertues.. të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Për sa më sipër, pretendimi i OE “FATOS LASHI” p.f në lidhje me paraqitjen e dokumenteve origjinalë ose kopje të njësuara me origjinalin nuk qëndron dhe kërkesa e tij për këto dokumente nuk pranohet.

2. Përsa i përket pretendimit se dokumenti “Konformitet i dosjes lidhur me substancën aktive...” i datës 08.09.2016 është një dokument sqarues që të ndihmojë AK-në shqyrtimin e ofertës, nga shqyrtimi i ankimit nga KSHA-ja, rezulton se ky dokument është paraqitur në dosjen e tenderit si pjesë e dokumentit të "paraqitur nga ju tek “deklarata për përbërësit aktivë " (edhe pse është përkthyer që bashkëlidhur deklaratës për përbërësit e lëndës aktive do të jetë dokumenti origjinal nga Ministria Franceze e Mjedisit, dhe në fakt është bashkëlidhur dokumenti copje e ANSES që i dërgohet Ministrisë Franceze të Mjedisit (dokumenti copje e vitit 2016. Në ankimit tuaj juve keni paraqitur informacion të ndryshëm nga dokumenti i prezantuar në tender. Sqarojmë se AK-ja merr në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e paraqitur në tender në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në DST.

3.Përsa i përket pretendimit se "skeda teknike e dozatorit i përmban të dyja shkallëzimet për të matur me të dyja njësitë sipas gjendjes së lëndës që duhet të matet pas verifikimit të skedës teknike, KSHA-ja konstaton se Dozatori MMF shoqëruar me Skeden teknike nuk është i saktë, duke mos mundësuar një matjen ekzakt të sasisë 1ml/m2. Dozatori i paraqitur nga ana e OE, nuk plotëson specifikimet teknike të cilat kërkojnë nga DST e tenderit “shtojca 9 “, ku kërkohet se “. OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m2. Skeda teknike e paraqitur nga ana juaj nuk është e qartë, duke mos paraqitur një dozator me ndarje vëllimore prej 1ml. Autoriteti kontraktor, duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njohimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 53/3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Për sa më sipër, pretendimi i OE “FATOS LASHI” p.f nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

4 . Përsa i përket pretendimit se “nuk është kërkuar të paraqitet asnjë dokument nga ECHA në DST, por që lënda bazë e produkteve të jetë e regjistruar në ECHA, KSHA sqaron se në DST, shtojca nr. 8, pika 3.3 “Kapaciteti teknik” pika 4 është kërkuar që: “OE duhet të paraqesë certifikatën e regjistrimit të produkteve biocide me agjent biologjik Bli ËG dhe Bli G, në një prej vendeve të Bashkimit Europian ose në Angli, Zvicër, Kanada, Australi, dhe SHBA të regjistruar në ECHA (Agjensia Evropiane e Kimikateve, organi më i madh për kimikatet në Evropë). Pra si cilësohet në DST duhet që produkti të jetë i regjistruar në ECHA por nga ana juaj nuk është ofruar asnjë informacion ose dokument për regjistrimin e këtyre produkteve në ECHA. Nga verifikimi që KSHA bëri në datën 04.10.2019 në ëbsite-n e ECHA i përditësuar në datë 13.09.2019 (pra pas ri-regjistrimit të produkteve në Francë rezulton se produktet AcuaBac DF 3000 dhe AuaBac 200G janë të anuluar për Francën. Certifikata nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dt. 12 Mars 2016, për produktin me përmbajtje të Bti BMP 144 DF 3000 me nr. rregjistrimi 62637-14 dhe Bti BMP 144 (200G) me nr. rregjistrimi 62637-3, është paraqitur vetëm vërtetim përkthimi dhe dokumentet nuk janë origjinalë ose njësi me origjinalin. Kjo certifikatë nuk provon që produkti është i regjistruar në ECHA. Dokumentat

e mësipërme nuk janë të rregullta dhe nuk përmbushin kriterin e përcaktuar nga AK-ja në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht shtojca nr. 8 ku në fund të saj cilësohet se të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të paskam konsiderohen si kushte për skualifikim. Në lidhje me regjistrimin e ri në Francë në muajin gusht 2019, dokumentet “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. A MM: FR-2019-0101” për produktin Aquahac DF 3000, dhe “Vendim në lidhje me kërkesën e Autorizimit për hedhjen në treg të një produkti biocid Nr. AMM: FR-2019-0099 për produktin AquaBac 200G, të Agjencisë Franceze të Shëndetit dhe Sigurisë së Ushqimit, Mjedisit dhe Punësimit (ANSES) nuk provojnë regjistrimin e produkteve të sipërpërmendura në ECHA. Për më tepër që këto dy dokumente të paraqitur prej jush nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit edhe të përkthimit të tij, rezulton se në të është shënuar qartësisht në kapitullin 1.2 "emri dhe adresa e mbajtësit" të këtij dokumentacioni, i cili është CERA SAS, me adresë: 16 Rue de Sain -Petersbur 75008 Paris. Përsa më sipër dokumenti i paraqitur nga ana juaj nuk mund të jetë origjinal, i poseduar aktualisht nga ju, sepse dokumentacioni origjinal qendron tek mbajtësi i tij dhe nga ana juaj nuk është bërë as njësimi me origjinalin. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Për sa më sipër, ju nuk vërtetoni që rodukti është i regjistruar në ECHA. KShA-ja verifikoi edhe në datën e sotme 04.10.2019 në ëbsite e ANSES <https://www.anses.fr/en/decisions/biocide>, dhe produktet Aquabac 2006 dhe Aquabac DF 3000, kanë ende certifikimet e regjistrimeve të datës 30 qershor 2016 (30 June 2016), të cilat janë anuluar që prej datës 18 Qershor 2018. KSHA përsëri bëri një verifikim në datën 04.10.2019, në lidhje me regjistrimin në ECHA të produkteve Biocideve Aquabac 200 G dhe Aquabac DF 3000, ku u verifikua përsëri në sistemin e ECHA dhe konfirmohet se produktet e ofruara sipas ëbsite <https://echa.europa.eu/infonation-on-chemicals/biocidalproducts> janë në statusin e anuluar, për Francën, për AquaBac 200G, ndërsa për produktin Aquabac DF 3000 është në statusin e anuluar si për Francën ashtu edhe për Spanjën. Madje rezulton se produkti AquaBac 200G është anuluar edhe në Greqi. Gjithashtu u verifikua edhe në ëbsite-in e CERA <http://cera-biocide.fr/aquabac-df3000/> dhe <http://cera-biocide.fr/aquabac-200g/>, në të cilin shfaqen vetëm regjistrimet e vjetra të produkteve të mësipërme për vitin 2016. Për sa më sipër, produktet nuk janë të regjistruar në ECHA. Bashkëlidhur do të gjeni dokumentet për verifikimet e kryera sa më sipër. Për sa më sipër, pretendimi i OE “FATOS LASHI” p.f nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet.

5. Përsa i përket pretendimit se gabimi në plotësimin e Formularit të Ofertës është një gabim njerëzor ju sqarojmë se Formulari i Ofertës nuk është paraqitur sipas përcaktimeve në DST-të përkatëse për Lotin 1 dhe përmban një sërë gabimesh, si më poshtë: Formulari i Ofertës ekonomike i referohet Prefekturës Vlorë, ndërkohë që Loti 1 është për kryerjen e procesit të dezinfektimit në Prefekturat Shkodër, Lezhë; Çmimi total i ofertës në faqen e parë është 73705 lekë pa TVSh, ndërsa tek tabela më poshtë, në faqen e dytë, totali çmime njësi është në vlerën 46110 lekë pa TVSh. Pra nuk ka përputhje midis vlerës së dhënë për çmimin total të ofertës me shumatoren e çmimeve për njësi; Zonat në tabelë, ashtu si edhe tek emërtimi i Shtojcës i referohen Lotit 4. Prefektura Vlorë, në kundërshtim me objektin e prokurimit të Lotit 1. Sa më sipër, si dhe referuar pikës 1 të Nenit 51 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit nr. 9643,

datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji. Gjithashtu në zbatim të pikës 2 të po këtij neni një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën. Për sa më sipër, pretendimi i OE “FATOS LASHI” p.f nuk qëndron dhe kërkesa e tij nuk pranohet. [...]”

II.6.3.Në datën 14.10.2019, operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7. Në datat 21.10.2019 dhe 24.10.2019, nëpërmjet shkresave nr. 1176/37 prot., datë 18.10.2019 dhe nr. 1176/44 prot., datë 23.10.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomik ankimes.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: “[...]1. Fatura e datës 19/05/2017 me nr.V2/77/2017 nga Tifone ambient, dhe fatura IEnv Solution l.t.d dt. 06.03.2019, nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe. Sipas DST-ve, kapitulli I; NJOFTIMI I KONTRATËS pika4.6, gjuha 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: , është gjuha shqipe. Jeni në kundërshtim me VKM –në nr. 914 datë 29/12/2014 për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik (të ndryshuara), neni 14 pika 2 [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën nr. 8 (Loti I), pikën 3.3.2, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.OE duhet të disponojë makineritë dhe paisjet e mëposhtme:

a.Aparat mjegullues për mjegull të ftohtë dhe Pompë me presion të lartë të montuar në një kamionçinë për lotet si më poshtë:

Të paktën 1 (një) Aparat mjegullues me pompë me presion, të montuar në një kamionçinë për Lotin 1.

Për këto pajisje OE ofertues duhet të paraqesë dokumentat si më poshtë:

i.Në rastin e pronësisë, OE duhet të paraqesë:

-lejen e qarkullimit të kamionçinës, (në të cilën është montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë). Pesha mbajtëse e kamionçinës të jetë jo më pak se 1 (një) ton, logo e dukshme e kompanisë;

-dhe certifikata e pronësisë;

-dhe kolaudimin të vlefshëm në momentin e hapjes së procedurës;

-dhe TPL-në e kamionçinës të vlefshme në momentin e hapjes së procedurës

-dhe vetëdeklarata që kamionçina do të jetë e kolauduar dhe pajisur me TPL përgjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës

-dhe foto të kamionçinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të aparatit mjegullues.

ii.Në rastin kur mjetet janë në përdorim, OE duhet të paraqesë:

-kontratën e qirasë me kohëzgjatje përgjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të kamionçinës, ku të jetë montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë;

-dhe një deklaratë se do të përdorë ekzaktësisht të njëjtën lloj kamionçine, aparat mjegullues dhe pompë me presion të lartë (me të cilën ka ofertuar), përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës;

-dhe foto të makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të aparatit mjegullues.

iii.OE duhet të paraqesë data sheet/skedën teknike/katalog për aparatit mjegullues dhe pompë me presion të lartë që disponon sipas kërkesave të dhëna në specifikimet teknike.

b.OE duhet të disponojë të paktën 1 (një) Atomizator shpine me motorr për granula për Lotin 1. Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

-faturën e blerjes së pajisjes atomizatorit/ në rastin kur pajisja (atomizator) është në përdorim, OE duhet të paraqesë kontratën e qirasë të shoqëruar me faturën e blerjes së pajisjes atomizator;

-dhe skedën teknike/katalogun e pajisjes sipas kërkesave të dhëna në specifikimet teknike.”

III.1.2.Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm si më poshtë vijon:

“ISHTE

2.OE duhet të disponojë makineritë dhe pajisjet e mëposhtme:

a.Aparat mjegullues për mjegull të ftohtë dhe Pompë me presion të lartë të montuar në një kamionçinë për lotet si më poshtë:

Të paktën 1 (një) Aparat mjegullues me pompë me presion, të montuar në një kamionçinë për Lotin 1.

Për këto pajisje OE ofertues duhet të paraqesë dokumentat si më poshtë:

a.Në rastin e pronësisë, OE duhet të paraqesë:

-lejen e qarkullimit të kamionçinës, (në të cilën është montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë). Pesha mbajtëse e kamionçinës të jetë jo më pak se 1 (një) ton, logo e dukshme e kompanisë;

-dhe certifikata e pronësisë;

-dhe kolaudimin të vlefshëm në momentin e hapjes së procedurës;

-dhe TPL-në e kamionçinës të vlefshme në momentin e hapjes së procedurës

-dhe vetëdeklaratë që kamionçina do të jetë e kolauduar dhe pajisur me TPL përgjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratë

-dhe foto të kamionçinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të aparatit mjegullues.

b.Në rastin kur mjetet janë në përdorim, OE duhet të paraqesë:

-kontratën e qirasë me kohëzgjatje përgjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të kamionçinës, ku të jetë montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë;

-dhe një deklaratë se do të përdorë ekzaktesisht të njëjtën lloj kamionçine, aparat mjegullues dhe pompë me presion të lartë (me të cilën ka ofertuar), përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës;

-dhe foto të makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të aparatit mjegullues.

c.OE duhet të paraqesë data sheet/skedën teknike/katalog për aparatit mjegullues dhe pompë me presion të lartë që disponon sipas kërkesave të dhëna në specifikimet teknike.

BËHET

2.OE duhet të disponojë makineritë dhe paisjet e mëposhtme:

a.Te pakten 1 (një) Aparat mjegullues dhe Pompë me presion të lartë të montuar në një kamioncinë

b.OE duhet të paraqesë data sheet/skedën teknike/katalog për aparatit mjegullues dhe pompë me presion të lartë që disponon sipas kërkesave të dhëna në specifikimet teknike.

c.Të paraqesi faturën e blerjes dhe/ose deklaratën doganore për Aparatin mjegullues dhe pompen me presion si dhe në rastin kur Aparati mjegullues dhe Pompa me presion të lartë janë në përdorim shoqëruar edhe me kontratën në përdorim përgjatë gjithë periudhës së Marrëveshjes Kuadër.

d.Në lidhje me kamioncinën, mjeti duhet të jetë në pronësi ose në përdorim nga OE ofertues

Kjo gjë duhet të vërtetohet me dokumentat si më poshtë

-Në rastin e pronësisë me lejen e qarkullimit dhe certifikatën e pronësisë, të kamioncinës.

-Në rastin kur mjeti është në përdorim të paraqitet edhe kontrata e qirasë përgjatë gjithë periudhës së Marrëveshjes Kuadër, të shoqëruar me lejen e qarkullimit dhe certifikatën e pronësisë.

e.Të paraqiten edhe foto të makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorit të aparatit mjegullues.

Shënim: është në përgjegjësinë e plotë të OE mbajtja e dokumentacionit të qarkullimit të kamioncinës , në përputhje më parashikimet ligjore në fuqi”

III.1.3.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë shitje nr.V2/77/2017, me cilësinë e shitësit ”Tifone Ambiente” S.r.l. dhe cilësinë e blerësit “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., shoqëruar me Deklaratë doganore, lëshuar nga Drejtoria e Doganave e RSH.

- Faturë shitje nr.0000089630, me cilësinë e shitësit "1 Env Solutions" Ltd. dhe cilësinë e blerësit "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k., shoqëruar me urdhër clirimi dhe Deklaratë doganore, lëshuar nga Drejtoria e Doganave e RSH dhe certifikata transportimi të lëshuara nga degët e dogënore të Malit të Zi dhe të Slovenisë.

III.1.4.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."*

III.1.5.Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit, operatori ekonomik ankimues "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k. ka paraqitur fatura shitje në gjuhë të huaj, si dhe deklaratat doganore përkatëse në gjuhën shqipe. Në këto kushte, Komisioni gjykon se pavarësisht se faturat e paraqitura nga ankimuesi nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, ky i fundit arrin të vërtetojë disponimin e pajisjeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor me anë të deklaratave doganore, të cilat janë në përputhje me kërkesat në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Komisioni thekson se, edhe në rast se nuk do të merreshin në konsideratë faturat në gjuhë të huaj, përsëri kriteri përmbushet nga deklaratat doganore. Sqarojmë, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik (pajisjet), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k. e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, (Loti I) pika 3.3.2 "Kapaciteti teknik" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k. qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: *"[...]2. Të dhënat e sigurisë të produkteve Vectobac WDG dhe Vectobac G, është njësuar vetëm përkthimi, por nuk është bërë njësia me origjinalin. Në DST, shtojca nr.8 Dokumentat e tenderit, duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar e tyre. Dokumenti nuk është i saktë, gjë e cila përbën kusht s'kualifikimi[...]".* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën nr. 8 (Loti I), pikën 3.3.3, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“3.OE duhet të paraqesë etiketat/katalog dhe Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë për të gjitha produktet e përcaktuar sipas loteve në lidhje me lëndët dezinfektuese që do të përdoret në trajtim sipas formulimeve të përcaktuara në specifikimet teknike më poshtë.

Formulimet dhe përqëndrimet e lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren:

a.Agjenti biologjik Bacillus thuringiensis israelensis (Bti) mikrogranula të tretshme në ujë (ËG) me fuqi 3000 I.T.U./mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare).

b.Agjenti biologjik Bacillus thuringiensis israelensis (Bti) granular (G) me fuqi 200 I.T.U për mg.

c.Film monomolekular (MMF) është një produkt me bazë silikon, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqëndrimin 1ml/m2.”

III.2.2.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër, ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Të dhënat e sigurisë të produktit VectoBac WDG në formë origjinale, në gjuhën angleze dhe të përkthyer në gjuhën shqipe shoqëruar me vërtetim përkthimi nga noter publik nr.388rep.
- Të dhënat e sigurisë të produktit VectoBac G në formë origjinale, në gjuhën angleze dhe të përkthyer në gjuhën shqipe shoqëruar me vërtetim përkthimi nga noter publik nr.389rep.

III.2.3.Në nenin 62, të ligjit nr.110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë” parashikohet shprehimisht se: *“1. Noteri, përveç kompetencave të parashikuara në ligje të veçanta, harton akte, kryen njësimet, vërtetime dhe verifikime në të gjitha çështjet, duke përfshirë, por pa u kufizuar: a) harton testamente; b) harton aktin për shfuqizimin plotësisht ose pjesërisht të testamenteve; c) harton procesverbalin e çeljes së testamenteve; ç) pranon për ruajtje testamente ollografë ose të posaçëm; d) lëshon dëshmi trashëgimie ligjore/testamentare; dh) harton akte noteriale, projekte për veprime të tjera juridike e dokumente, jep kopje dokumentesh ose shkurtime të tyre; e) bën njoftimin e kujtesës noteriale brenda dhe jashtë vendit; ë) legalizon nënshkrimet e shtetasve të vëna në dokumente të ndryshme; f) harton kundërshtimet e kambialeve dhe vërtetimin e mospagesës së çekut; g) vërteton datën e paraqitjes së dokumenteve në zyrën e noterisë; gj) vërteton qenien e një personi dhe qëndrimin e tij në një vend të caktuar; h) pranon për ruajtje dokumente të personave fizikë e juridikë në zyrën noteriale; i) vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara; j) bën ose vërteton përkthime nga një gjuhë në një tjetër, vetë ose nëpërmjet një përkthyesi të licencuar, të pranuar nga palët ose kërkuesi; k) harton procesverbale, bën inventarë të sendeve, të dokumenteve, korrespondencave postare ose elektronike, komunikimeve elektronike, dokumenteve elektronike të vulosura me vulë dixhitale, portaleve, komunikimeve të aplikacioneve, dokumenteve të tjera të publikuara, duke përshkruar gjendjen e sendeve,*

rrethanat e konstatuara gjatë hartimit të procesverbalit dhe, në rastin e korespondencave, përshkrimin e të dhënave të dërguesit dhe të marrësit, sipas kërkesës së shtetasve; l) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare; ll) harton akte noteriale, prokura, kontrata, marrëveshje, deklarata e dokumente të tjera të kërkuar nga personat e interesuar, si dhe akte e veprime të tjera, që sipas ligjit janë në kompetencën lëndore të noterit; m) merr në ruajtje vlera monetare, bono, letra me vlerë ose sende të tjera me vlerë për palët ose për t'ia dorëzuar këto sende një pale të tretë në rastin e një interesi legjitim të sigurisë për palët; n) ofron konsulenca juridike për problematika të ndryshme në fushën e veprimtarisë noteriale; nj) kërkon nga personat fizikë e juridikë të dhëna e dokumente që janë të domosdoshme për kryerjen e akteve dhe veprimeve noteriale; o) refuzon kryerjen e veprimeve ose akteve noteriale në rast se dokumentacioni i paraqitur nga pala kërkuese nuk është i plotë; objekti ose përmbajtja e tyre është në kundërshtim me ligjin dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, ose në raste të tjera ku noteri krijon bindjen personale se veprimi ose akti noterial i kërkuar është fiktiv. 2. Noteri këshillon palët për të gjitha çështjet ligjore që lidhen me aktet ose veprimet noteriale, veçanërisht, por pa u kufizuar, në hartimin e kontratave dhe marrëveshjeve të të gjitha llojeve dhe asistencës në procesimin e transaksioneve”

III.2.4.Në nenin 138, të ligjit nr.110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë” parashikohet shprehimisht se: *“1.Pavlefshmëria e aktit ose e veprimit noterial mund të kërkohej nga personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij dhe nga çdo person që heq të drejta e merr përsipër detyrime prej tyre. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale. 2. Në vendimin e gjykatës që deklaron të pavlefshëm një akt noterial, urdhërohet zyra përkatëse e noterisë të bëjë shënimet e duhura në origjinalin e aktit, i cili ndodhet i depozituar në këtë zyrë”*

III.2.5.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.2.6.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet dhe të vlerësojë arsyen e vendosjes dhe çfare këkron të vërtetojë autoriteti kontraktor me kriterin e vendosur në pikën 3.3.3, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në përgjigje të vlerësimit dhe interpretimit literal të kriterit të sipërcituar, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nëpërmjet kriterit për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat e sigurisë, kërkon të njihet me rrezikshmërinë, pasojat dhe masat që duhen marrë etj. për përdorimin e lëndëve desinsektuese që do të përdorin operatorët ekonomik ofertues për zbatimin e kontratës objekt i procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektornike, KPP konstaton se

dokumentat lidhur me të dhënat e sigurisë të paraqitura elektronikisht, në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, janë një origjinal në gjuhën angleze dhe janë të përkthyer në gjuhën shqipe e të noterizuar me nr.388rep. dhe nr.389rep. Sa më sipër, KPP konkludon se operatori ekonomik ankimues e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 3.3.3, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, pasi dokumentat e dorëzuara elektronikisht janë origjinale dhe nuk kanë nevojë për njëhësim me origjinalin sipas parashikimeve në pikën “i” të nenit 62, të ligjit nr.110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, por vetëm për vërtetim përkthimi sipas pikës “j” të nenit të sipërcituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: “[...]3. *Formulari i ofertës Shtojca 1 (Lot1) duhet të kishit deklaruar në pikën (1) dhe në pikën(2), më gërma dhe me numra vetëm shumatoren e cmimeve për njësi. Plotësimi i formularit nga ana juaj është bërë në kundërshtim me DST e tenderit, dhe Rekomandimit nr. 10419, datë 26.11.2018 të APP “Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër”[...]*

III.3.1.Në shtojcën 1 (Loti I), të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. *Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;*
2. *Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH*

Lot. 1 “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë”.

Nr.	Zonat	Teknikat / Mënyra e ndërhyrjes	Lendet aktive dhe formulimi që do të përdoret për trajtim	Përqëndrimi i produktit që do të përdoret në trajtim	Sipërfaqja e parashikuar	Cmimi/Njesi pa TVSH
<i>LOT I Prefektura: Shkodër, Lezhe</i>						
		<i>Cold fogging</i>	<i>Bti WG</i>	<i>1 kg/ha</i>	<i>1</i>	<i>ha</i>
		<i>Atomizator shpine me motorr per granula</i>	<i>Bti G</i>	<i>10 kg/ha</i>	<i>1</i>	<i>ha</i>
		<i>Pompë me presion të lartë</i>	<i>Bti WG</i>	<i>1 kg/ha</i>	<i>1</i>	<i>ha</i>
		<i>Dozator per leng</i>	<i>Monomolek</i>	<i>1ml/m²</i>	<i>1</i>	<i>m2</i>

		<i>per bodrume dhe puseta</i>	<i>ular film</i>				
<i>Totali çmime njësi</i>							
<i>TVSH (20%)</i>							
<i>Totali me TVSH</i>							

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe shqyrtimi i shtojcës 1 "Formulari i ofertës", i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k., KPP konstaton se në këtë shtojcë është paraqitur oferta ekonomike si më poshtë vijon:

"Cmimi total i ofertës sonë është: 9,934,400 lekë pa TVSH"

"Cmimi total i ofertës sonë është: 11,921,280 lekë me TVSH"

Nr.	Zonat	Teknikat / Mënyra e ndërhyrjes	Lendet aktive dhe formulimi që do të përdoret për trajtim	Përqëndrimi i produktit që do të përdoret në trajtim	Sasia	Njësia	Cmimi/Njesi pa TVSH
<i>LOT I Prefektura: Shkodër, Lezhë</i>							
		<i>Cold fogging</i>	<i>Bti WG</i>	<i>1 kg/ha</i>	<i>1</i>	<i>ha</i>	<i>25,400</i>
		<i>Atomizator shpine me motorr per granula</i>	<i>Bti G</i>	<i>10 kg/ha</i>	<i>1</i>	<i>ha</i>	<i>4,500</i>
		<i>Pompë me presion të lartë</i>	<i>Bti WG</i>	<i>1 kg/ha</i>	<i>1</i>	<i>ha</i>	<i>4,500</i>
		<i>Dozator per leng per bodrume dhe puseta</i>	<i>Monomolek ular film</i>	<i>1ml/m²</i>	<i>1</i>	<i>m²</i>	<i>2.5</i>
<i>Totali çmime njësi</i>							<i>34,402.5</i>
<i>TVSH (20%)</i>							<i>6,880.5</i>
<i>Totali me TVSH</i>							<i>41,283</i>

III.3.3. Në nenin 66, pika 4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: - Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta

ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.-Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.”

III.3.4. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., ka dorëzuar Formularin e ofertës ekonomike në të cilën, në pjesën deklarative të ofertës është ofruar vlera totale 9,934,400 lekë pa TVSH dhe vlera 11,921,280 lekë me TVSH, ndërsa në tabelën ku pasyrohen çmimet për njësi, vlerat e shumatores së cmimeve për njësi janë 34,402.5 pa TVSH dhe 41,283 me TVSH. Komisioni vëren se, pavarësisht se në Formularin e ofertës, vlera e ofruar në pjesën deklarative të ofertës ekonomike është vlera totale e pritshme, si në vlerën e ofruar pa TVSH edhe në vlerën e ofruar me TVSH, në tabelën analitike të ofertës tip të hartuar nga autoriteti kontraktor, ankimuesi ka pasqyruar ofertën e tij sipas cmimeve për njësi, si dhe totalin e shumatores të cmimeve për njësi. KPP gjykon se nuk ndodhemi në kushtet e një gabimi aritmetik gjatë shumëzimit ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, apo të mospërputhjeve të dy vlerave të deklaruara. Vlen të theksohet, se në formularin e ofertës të paraqitur autoriteti kontraktor e ka tërësisht mundësinë të njihet me vlerën reale të ofruar për njësi nga operatori ekonomik ankimues, duke u vërtetuar me faktin që dhe vetë autoriteti kontraktor e ka klasifikuar këtë operator ekonomik sipas shumatores së çmimit për njësi të ofruar nga ky i fundit. Për këto arsye, autoriteti kontraktor nuk ka vepruar drejtë për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga ankimuesi, pasi nuk ndodhemi në kushtet e gabimeve aritmetike sikurse parashikon akti nënligjor i sipërcituar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të pranohen nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: “[...]5. Skeda teknike e Dozatorit MMF është e gabuar. Dozatori I paraqitur nga ju nuk plotëson specifikimet teknike të cilat kërkohen nga DST e tenderit “shtojca 9 “, ku kërkohet se “..... OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m². . Skeda teknike e paraqitur nga ana e Pastrimi Silvio shpk është dozator mekanik i rregullueshëm (DOSAMATIC gr), e cila tregon qartësisht tek fusha e aplikimit të pasijes e cila përdoret për produkte me formulime granule me doze (nga 2gr -10 gr), ndërkohë që DST e kërkojnë për përdorim me formulim lëng deri në 1ml. Nuk plotëson kriteret e

vecanta per kualifikim ne lidhje paisjen Dozatore MMF dhe specifikimet teknike per Dozatorin per MMF. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1.Në shtojcën nr. 8 (Loti I), pikën 3.3.2/c, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“c.OE duhet të disponojë të paktën 3 (tre) Dozatorë për MMF (monomolekular film) për Lotin 1. Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

-vetëdeklaratë se disponon dozatorët

-dhe data sheet, ose katalogun e Dozatorit, sipas kërkesave të dhëna në specifikimet teknike.”

III.4.2.Në shtojcën 9 “Specifikimet Teknike” dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“3.Film monomolekular është një produkt me bazë silikoni, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqendrimin 1ml/m²”

6. Teknika me mjetin Dozator për lëng.

Teknika dozator për lëng përdoret në rastin e trajtimit të bodrumeve, gropave septike dhe pusetave me ujë të ndenjtur. Trajtimi kryhet duke hedhur solucionin e lëngshëm të filmit monomolekular në njësi matëse në mililitra ose dozues (dozator) në varësi të sipërfaqes që duhet trajtuar një herë në muaj (4 javë).

Duke qenë shumica e pusetave janë të mbyllura me kapak hekuri ose janë të izoluara ose janë të pajisura me një vrimë shumë të vogël nga ku nuk mund të monitorohen dhe shihen larvat, sugjerojmë që të trajtohen vetëm pusetat e hapura që kanë ujë të ndenjtur të qëndrueshëm, uji të mos rrjedh dhe që të monitorohen lehtë me pajisjet monitoruese; si edhe ato puseta ku duket qartë që ka larva edhe nëse pajisja monitoruese nuk mund te futet. Trajtimi për pusetat e gjetura të kryhet me produktin Monomolekular film në masën 1ml për pusetë (1ml/m²). Të mos trajtohen pusetat pa uë, të thata, ato që kanë ujë të rrjedhshëm dhe pusetat që nuk dallohet se kanë ujë dhe larva.

Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

•OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqendrimin 1ml/m².

•Veprimi rezidual, duhet të monitorohet nga NJVKSH dhe Operatoridhe AK (ISHP) në prani të OE pas 2, 14 dhe 28 ditëve.

•Nëse nga procesi i monitorimit entomologjik pas 48 orësh që është kryer trajtimi, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet ta ritrajtojë menjëherë vatrat pozitive për praninë e larvave me shpenzimet financiare të tij, që nuk mbulohen nga AK.

•OE duhet të printojë dhe të ketë përpara fillimit të aplikimit, hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen, të përgatitur nga NJVKSH dhe Operatori, të cilat mund të mbështëten teknikisht nga ISHP/AK.

•OE duhet të bashkëpunojë me pushtetin lokal dhe komunitetin.

•OE duhet të paraqesë të printuar hartën e zonave pas trajtimit.

III.4.3.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë shitje, me cilësinë e shitësit ”Bleu Line” S.r.l. dhe cilësinë e blerësit “Pastrime Silvio” sh.p.k., shoqëruar me Deklaratë doganore dhe urdhër clirimi, lëshuar nga Drejtoria e Doganave e RSH, skedë teknike dhe fotografi të dozatorit.

III.4.4.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.4.5.Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit, operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k. ka paraqitur faturë shitje, deklaratat doganore përkatëse në gjuhën shqipe, skedën teknike dhe fotografitë e dozatorit Dosamatic GR. Nga shqyrtimi i skedës teknike, Komisioni vëren se, dozatori mekanik i rregullueshëm, ka një kapacitet 10 litra dhe përdoret në të gjitha ndërhyrjet ku kërkohet saktësia e dozimit të formulimeve të grimcuar antilarval. Gjithashtu konstatohet se, ky dozator është i kalibrueshëm nga 2 deri në 10 gram. Në këto kushte, Komisioni gjykon se dozatori Dosamatic GR, i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nuk përmbush kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi autoriteti kontraktor ka përcaktuar në mënyrë eksplicite dhe shteruese, se operatori ekonomik duhet të disponojë dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m², dhe jo të grimcuar me përqëndrim në gram. Sqarojmë, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik (pajisjet), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, (Loti I) pika 3.3.2/c “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.4.6. Në rast se operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin

procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankimi në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k. nuk qëndron.

III.5.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.6.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: “[...]10. Skeda teknike e Dozatorit MMF është e gabuar sespe nuk plotëson specifikimet teknike në DST e tenderit. OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m2. Me dozatorin e paraqitur nga ana juaj nuk mund të verifikohet saktësisht matja 1ml [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1.Në shtojcën nr. 8 (Loti I), pikën 3.3.2/c, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“c.OE duhet të disponojë të paktën 3 (tre) Dozatorë për MMF (monomolekular film) për Lotin I. Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

-vetëdeklaratë se disponon dozatorët

-dhe data sheet, ose katalogun e Dozatorit, sipas kërkesave të dhëna në specifikimet teknike.”

III.6.2.Në shtojcën 9 “Specifikimet Teknike” dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“3.Film monomolekular është një produkt me bazë silikoni, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqendrimin 1ml/m2”

6. Teknika me mjetin Dozator për lëng.

Teknika dozator për lëng përdoret në rastin e trajtimit të bodrumeve, gropave septike dhe pusetave me ujë të ndenjtur. Trajtimi kryhet duke hedhur solucionin e lëngshëm të filmit monomolekular në njësi matëse në mililitra ose dozues (dozator) në varësi të sipërfaqes që duhet trajtuar një herë në muaj (4 javë).

Duke qenë shumica e pusetave janë të mbyllura me kapak hekuri ose janë të izoluara ose janë të pajisura me një vrimë shumë të vogël nga ku nuk mund të monitorohen dhe shihen larvat, sugjerojmë që të trajtohen vetëm pusetat e hapura që kanë ujë të ndenjtur të qëndrueshëm, uji të mos rrjedh dhe që të monitorohen lehtë me pajisjet monitoruese; si edhe ato puseta ku duket qartë që ka larva edhe nëse pajisja monitoruese nuk mund te futet. Trajtimi për pusetat e gjetura të kryhet me produktin Monomolekular film në masën 1ml për pusetë (1ml/m2). Të mos trajtohen pusetat pa uë, të thata, ato që kanë ujë të rrjedhshëm dhe pusetat që nuk dallohet se kanë ujë dhe larva.

Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

•OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m2.

•Veprimi rezidual, duhet të monitorohet nga NJVKSH dhe Operatoridhe AK (ISHP) në prani të OE pas 2, 14 dhe 28 ditëve.

•Nëse nga procesi i monitorimit entomologjik pas 48 orësh që është kryer trajtimi, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet ta ritrajtojë menjëherë vatrat pozitive për praninë e larvave me shpenzimet financiare të tij, që nuk mbulohen nga AK.

•OE duhet të printojë dhe të ketë përpara fillimit të aplikimit, hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen, të përgatitur nga NJVKSH dhe Operatori, të cilat mund të mbështëten teknikisht nga ISHP/AK.

•OE duhet të bashkëpunojë me pushtetin lokal dhe komunitetin.

•OE duhet të paraqesë të printuar hartën e zonave pas trajtimit.

III.6.3.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f., në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar skedë teknike në gjuhë të huaj dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

III.6.4.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.6.5.Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit, operatori ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. ka paraqitur skedën teknike të dozatorit (cilindra prej xhami ose plastik). Nga shqyrtimi i skedës teknike, Komisioni vëren se, dozatorët cilindrik ka një kapacitet 100 dhe 250 mililitra me shkallëzim të shënuar minimalisht 10 ml. Gjithashtu konstatohet se, këto dozatorë nuk janë të kalibrueshëm. Në këto kushte, Komisioni gjykon se dozatorët e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nuk përmbushin kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi autoriteti kontraktor ka përcaktuar në mënyrë eksplicite dhe shteruese, se operatori ekonomik duhet të disponojë dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin 1ml/m². Sqarojmë, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik (pajisjet), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, (Loti I) pika 3.3.2/c “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.6.6. Në rast se operatori ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankimi në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.* Gjithashtu,

kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. nuk qëndron.

III.7.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative.

III.8.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “NRG” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.8.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

III.8.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjisllacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i

skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-33068-08-07-2019, me objekt: *LOTI 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë”*, me fond limit 9,943,883 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.09.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Fatos Lashi” p.f. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1614 protokollit Datë 11.10.2019;

Nr. 1619 protokollit Datë 11.10.2019;

Nr. 1621 protokollit Datë 14.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha